FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 137

Tiranë – E hënë, 7 tetor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ nr. 2, datë 2.10.2019	Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019"	11445
Akt normativ nr. 3, datë 2.10.2019	Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.....	11454
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 18.9.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.....	11454
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 639, datë 2.10.2019	Për kalimin e sporteleve të shërbimit në Administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)	11472
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 2.10.2019	Për përcaktimin e autoritetit përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe të rezultateve në punë.....	11473
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 2.10.2019	Për organizimin, funksionimin dhe fushën e veprimit të policimit vullnetar.....	11473
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 2.10.2019	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "MTSC" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore "ish-Ndërmarrje Metalike 'Tirana'" (Reparti i Orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë.....	11475
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 2.10.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1056, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik 'Për sigurinë e ashensorëve në përdorim'"	11485

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 644, datë 2.10.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 412, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rishikimi i projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës"'	11486
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 2.10.2019	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe të veprave ndihmëse në Njësinë Administrative Topojë, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Seman Sunpower" sh.p.k. dhe "Sonne" sh.p.k.....	11487
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 2.10.2019	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.....	11489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 647, datë 2.10.2019	Për lirimin nga detyra të drejtorit të Cirkut Kombëtar.....	11489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 648, datë 2.10.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës", të ndryshuar..	11489
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 2.10.2019	Për emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Elbasanit.....	11490
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 2.10.2019	Për sigurimin e ndërtimeve.....	11490
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 3.10.2019	Për disa shtesa në vendimin nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik", të ndryshuar.....	11491
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 171, datë 27.9.2019	Për miratimin e rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrit dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve"	11491

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 2.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 99/2018, "PËR BUXHETIN E VITIT 2019"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", bëhen këto ndryshime:

Neni l

Nenet 2, 3, 4, 5 dhe 8 ndryshohen si më poshtë vijojnë:

"Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2019 është:

Të ardhurat	361 945	milionë lekë;
Shpenzimet	394 845	milionë lekë;
Deficiti	32 900	milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2019 është:

Të ardhurat	55 286	milionë lekë;

nga të cilat:

- transferta e pakushtëzuar nga buxheti qendror	17 632	milionë lekë;
- transferta specifike	7 443	milionë lekë;
- të ardhura të tjera	30 211	milionë lekë.
Shpenzimet	55 286	milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2019 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej, 126 244 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	82 896	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	41 038	milionë lekë;
- transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2 310	milionë lekë;
Shpenzimet	126 244	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2019, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej, 5 844 milionë lekë;

nga të cilat:

- kontributet	1 446	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 258	milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve	140	milionë lekë;
Shpenzimet	5 844	milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është 2 450 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr. 7703 datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 618 milionë lekë dhe janë të ndara sipas skemave, në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2019 është:

Të ardhurat, gjithsej,	41 900	milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet dhe të tjera	13 729	milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	28 171	milionë lekë;
Shpenzimet	41 900	milionë lekë.

Fondi për rimbursimin e medikamenteve nuk tejkalon tavanin prej 11 000 milionë lekësh, përfshirë edhe pagesën e detyrimeve të prapambetura. Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

.....

Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	15 500	milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	323 604	milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	22 840	milionë lekë.”.

Neni 2

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	387 195	milionë lekë;
Fondi rezervë	2 000	milionë lekë;
Fondi rezervë i sistemit të drejtësisë	1 350	milionë lekë
Kontingjencë për risqet e borxhit	4 300	milionë lekë.”.

b) Tabelat 1 dhe 4, të përmendura në nenin 10, zëvendësohen, përkatësisht, me tabelat me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhen këtij akti normativ dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 3

Në nenin 11 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë bëhet 82 455 veta;

b) Tabela 2, e përmendur në nenin 11, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Në paragrafin e parafundit hiqen fjalët “... me miratim paraprak të Kuvendit.”;

ç) Në paragrafin e fundit, shuma “500 milionë lekë” bëhet “400 milionë lekë”.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit, prej 2 000 milionë lekësh, përdoret nga Këshilli i Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

Fondi rezervë i sistemit të drejtësisë përdoret:

- deri në 1 miliardë lekë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për financimin e pagave të reja të magjistratëve;
- deri në 350 milionë lekë, nga Këshilli i Ministrave, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Kontingjenca për risqet e borxhit, prej 4 300 milionë lekësh, përdoret nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në shpenzimet për interesa.

Shumat e shpërndara nga fondi rezervë i buxhetit, fondi rezervë i sistemit të drejtësisë dhe kontingjenca për risqet e borxhit shtojnë kufijtë e miratuar në tabelat 1 dhe 4, që përmenden në nenin 10, të këtij ligji.”.

Neni 5

Aneksi 3, që përmendet në nenin 16, zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numërtim, që i bashkëlidhet këtij akti normativ dhe është pjesë përbërëse të tij.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKTI NORMATIV NR. 1 2019 - SIPAS MINISTRIVE TË LINJËS DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE
(në 000/LEK)

Kodi	Emërtimi i institucionit /i programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
1	**Presidenca**	**242,000**	**6,000**	**0**	**6,000**	**248,000**
01120	Veprimtaria e Presidentit	242,000	6,000	0	6,000	248,000
2	**Kuvendi**	**1,108,560**	**180,000**	**0**	**180,000**	**1,288,560**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	410,828	180,000	0	180,000	590,828
01120	Veprimtaria ligjvënëse	697,732	0	0	0	697,732
3	**Kryeministria**	**490,000**	**200,000**	**330,000**	**530,000**	**1,020,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	490,000	200,000	330,000	530,000	1,020,000
5	**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**	**4,137,542**	**2,463,420**	**2,692,000**	**5,155,420**	**9,292,962**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	386,292	5,000	0	5,000	391,292
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,367,160	70,420	197,918	268,338	1,635,498
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe të ujitjes	692,074	2,080,000	755,800	2,835,800	3,527,874
04250	Zhvillimi rural, duke mbësht. prodh. bujq., blek., agroind. dhe market.	1,100,337	184,000	1,565,682	1,749,682	2,850,019
04860	Këshillimi dhe informacioni bujqësor	445,259	20,000	0	20,000	465,259
05470	Menaxhimi qëndrueshëm i tokës bujqësore	18,500	0	0	0	18,500
04230	Mbështetje për peshkimin	127,920	104,000	172,600	276,600	404,520
6	**Ministria e infrastrukturës dhe energjisë**	**4,554,080**	**23,678,492**	**17,902,132**	**41,580,624**	**46,134,704**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	615,200	13,000	0	13,000	628,200
04520	Transporti rrugor	1,879,270	15,125,100	7,348,132	22,473,232	24,352,502
04540	Transporti detar	99,000	100,000	0	100,000	199,000
04550	Transporti hekurudhor	420,900	153,500	754,000	907,500	1,328,400
04560	Transporti ajror	15,210	19,000	0	19,000	34,210
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	478,500	4,232,000	5,220,000	9,452,000	9,930,500
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	500,000	1,961,272	700,000	2,661,272	3,161,272
04320	Mbështetje për energjinë	102,900	1,697,000	3,660,000	5,357,000	5,459,900
04430	Mbështetje për burimet natyrore	159,500	128,000	0	128,000	287,500
04440	Mbështetje për industrinë	254,000	90,000	0	90,000	344,000
06180	Planifikimi urban	29,600	159,620	220,000	379,620	409,220
10	**Ministria e Financave**	**51,922,889**	**3,358,250**	**1,188,000**	**4,546,250**	**56,469,139**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	757,050	464,623	318,919	783,542	1,540,592
01120	Menaxhimi i shpenzimeve publike	457,923	5,000	0	5,000	462,923
01130	Ekzekutimi i pagesave të ndryshme	357,000	157,452	0	157,452	514,452
01140	Menaxhimi i të ardhurave tatimore	2,246,001	938,000	0	938,000	3,184,001
01150	Menaxhimi i të ardhurave doganore	3,254,597	472,227	76,437	548,664	3,803,261
01160	Lufta kundër transaksioneve financiare joligjore	89,400	27,000	0	27,000	116,400
04130	Mbështetje për zhvillim ekonomik	273,000	91,300	100,000	191,300	464,300
04160	Mbështetje për mbikëq. e tregut, infrast. e cilës. dhe pron. industr.	336,500	29,000	0	29,000	365,500
10220	Sigurimi shoqëror	40,241,750	0	0	0	40,241,750
10550	Tregu i punës	1,636,700	53,400	0	53,400	1,690,100
04170	Inspektimi në punë	172,968	10,000	0	10,000	182,968
09240	Arsimi i mesëm (profesional)	1,805,000	780,248	692,644	1,472,892	3,277,892
06190	Strehimi	295,000	330,000	0	330,000	625,000
11	**Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**	**35,417,184**	**3,544,000**	**300,000**	**3,844,000**	**39,261,184**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	725,042	72,000	0	72,000	797,042
09120	Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	21,081,500	1,720,000	0	1,720,000	22,801,500
09230	Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	6,224,643	1,062,000	0	1,062,000	7,286,643
09450	Arsimi universitar	6,817,999	340,500	100,000	440,500	7,258,499
09770	Fonde për shkencën	350,000	99,500	200,000	299,500	649,500
08140	Zhvillimi i Sportit dhe Rinisë	218,000	250,000	0	250,000	468,000
12	**Ministria e Kulturës**	**1,462,013**	**905,000**	**30,000**	**935,000**	**2,397,013**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	160,276	0	0	0	160,276
08220	Trashëgimia kulturore dhe muzetë	518,337	5,000	30,000	35,000	553,337
08230	Arti dhe kultura	783,400	900,000	0	900,000	1,683,400
13	**Ministria e Shëndetësisë**	**57,890,877**	**1,990,000**	**1,140,000**	**3,130,000**	**61,020,877**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	382,732	25,550	0	25,550	408,282
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	7,584,000	440,433	278,000	718,433	8,302,433
07330	Shërbimet e kujdesit dytësor	22,105,006	1,446,534	762,000	2,208,534	24,313,540
07450	Shërbimet e shëndetit publik	2,815,760	15,850	0	15,850	2,831,610
07460	Shërbimi Kombëtar i Urgjencës	301,000	20,098	0	20,098	321,098
10430	Përkujdesja sociale	23,455,079	41,535	100,000	141,535	23,596,614
01190	Rehabilitimi i të përndjekurve politikë	1,247,300	0	0	0	1,247,300
14	**Ministria e Drejtësisë**	**11,029,578**	**727,580**	**350,000**	**1,077,580**	**12,107,158**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	370,444	138,300	350,000	488,300	858,744
03310	Ndihma juridike	39,900	3,000	0	3,000	42,900
01120	Publikimet zyrtare	40,260	38,000	0	38,000	78,260
01130	Mjekësia ligjore	79,300	11,000	0	11,000	90,300
03440	Sistemi i burgjeve	5,391,174	472,000	0	472,000	5,863,174
03350	Shërbimi i përmbarimit gjyqësor	139,300	10,000	0	10,000	149,300
01160	Shërbimet për çështjet e birësimeve	10,700	200	0	200	10,900
01180	Shërbimi i kthimit dhe kompensimit të pronave	4,820,800	33,680	0	33,680	4,854,480
03490	Shërbimi i provës	137,700	21,400	0	21,400	159,100
15	**Ministria e Punëve të Jashtme**	**2,757,500**	**153,000**	**220,000**	**373,000**	**3,130,500**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	128,000	87,000	0	87,000	215,000
01120	Mbështetje diplomatike jashtë shtetit	2,331,000	35,000	0	35,000	2,366,000
01130	Aktiviteti diplomatik dhe konsullor i MPJ-së	207,500	0	0	0	207,500

Kodi	Emërtimi i institucionit /i programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
01150	Mbështetja institucionale për procesin e integrimit	91,000	31,000	220,000	251,000	342,000
16	**Ministria e Brendshme**	**19,091,211**	**1,366,556**	**994,868**	**2,361,424**	**21,452,635**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,168,000	131,100	0	131,100	1,299,100
03140	Policia e Shtetit	15,150,542	1,121,856	818,868	1,940,724	17,091,266
03150	Garda e Republikës	1,558,769	12,000	0	12,000	1,570,769
01160	Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara të Pushtetit Vendor	518,900	88,600	176,000	264,600	783,500
01170	Shërbimi i Gjendjes Civile	695,000	13,000	0	13,000	708,000
17	**Ministria e Mbrojtjes**	**18,532,417**	**3,515,500**	**0**	**3,515,500**	**22,047,917**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,185,000	30,000	0	30,000	1,215,000
02120	Forcat e luftimit	5,113,407	2,887,500	0	2,887,500	8,000,907
09430	Arsimi ushtarak	600,050	4,500	0	4,500	604,550
02150	Mbështetja e luftimit	5,393,410	175,000	0	175,000	5,568,410
07340	Mbështetje për Shëndetësinë	885,550	70,500	0	70,500	956,050
10270	Mbështetje sociale për ushtarakët	5,060,000	0	0	0	5,060,000
10910	Emergjencat Civile	295,000	348,000	0	348,000	643,000
18	**Shërbimi Informativ Shtetëror**	**1,475,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**1,525,000**
03520	Veprimtaria informative shtetërore	1,475,000	50,000	0	50,000	1,525,000
19	**Drejtoria e Radiotelevizionit**	**572,000**	**50,000**	**0**	**50,000**	**622,000**
08310	Shërbimet për shqiptarët jashtë kufirit	240,000	0	0	0	240,000
08520	Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	200,000	50,000	0	50,000	250,000
08330	Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	72,000	0	0	0	72,000
08340	Orkestra simfonike e RTSH-së dhe e Kinematografisë	60,000	0	0	0	60,000
20	**Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave**	**176,000**	**85,000**	**0**	**85,000**	**261,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	176,000	85,000	0	85,000	261,000
22	**Akademia e Shkencës**	**106,040**	**2,000**	**0**	**2,000**	**108,040**
01520	Veprimtaria akademike	106,040	2,000	0	2,000	108,040
24	**Kontrolli Lartë i Shtetit**	**397,900**	**20,000**	**0**	**20,000**	**417,900**
01120	Veprimtaria auditueese e KLSH-së	397,900	20,000	0	20,000	417,900
26	**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**	**1,283,840**	**629,000**	**515,000**	**1,144,000**	**2,427,840**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	220,000	11,040	0	11,040	231,040
05320	Programe për mbrojtjen e mjedisit	467,300	166,670	215,000	381,670	848,970
04260	Administrimi i pyjeve	439,540	97,790	300,000	397,790	837,330
04760	Zhvillimi i turizmit	157,000	353,500	0	353,500	510,500
28	**Prokuroria e Përgjithshme**	**1,620,000**	**130,000**	**0**	**130,000**	**1,750,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1,620,000	130,000	0	130,000	1,750,000
29	**Këshilli i Lartë Gjyqësor**	**2,215,450**	**162,000**	**0**	**162,000**	**2,377,450**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	94,450	2,620	0	2,620	97,070
03310	Buxheti gjyqësor	2,121,000	159,380	0	159,380	2,280,380
30	**Gjykata Kushtetuese**	**110,700**	**4,000**	**0**	**4,000**	**114,700**
03320	Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	110,700	4,000	0	4,000	114,700
31	**Agjencia Telegrafike Shqiptare**	**66,000**	**4,000**	**0**	**4,000**	**70,000**
08320	Veprimtaria telegrafike e ATSH-së	66,000	4,000	0	4,000	70,000
40	**Partitë politike**	**200,000**	**0**	**0**	**0**	**200,000**
01110	Mbështetje për partitë politike	190,000	0	0	0	190,000
01120	Mbështetje për shoqatat	8,000	0	0	0	8,000
01130	Mbështetje për organizatat e veteraneve me status	2,000	0	0	0	2,000
41	**Institucionet e SPAK-ut dhe BKH-së**	**66,000**	**0**	**0**	**0**	**66,000**
03390	Veprimtaria e SPAK-ut dhe BKH-së	66,000	0	0	0	66,000
50	**Instituti i Statistikës**	**631,340**	**31,000**	**150,000**	**181,000**	**812,340**
01320	Veprimtaria statistikore	631,340	31,000	150,000	181,000	812,340
55	**Shkolla e Magjistraturës**	**170,700**	**8,000**	**0**	**8,000**	**178,700**
09820	Veprimtaria arsimore	170,700	8,000	0	8,000	178,700
56	**Fondi i Zhvillimit Shqiptar**	**0**	**9,935,000**	**5,470,000**	**15,405,000**	**15,405,000**
06210	Programe zhvillimi	0	6,635,000	5,470,000	12,105,000	12,105,000
06220	Infrastruktura vendore dhe rajonale	0	3,100,000	0	3,100,000	3,100,000
04230	Programi "100 Fshatrat"	0	200,000	0	200,000	200,000
57	**Qendra Kombëtare e Kinematografisë**	**168,120**	**1,000**	**25,000**	**26,000**	**194,120**
08220	Mbështetja e veprimtarisë kinematografike	168,120	1,000	25,000	26,000	194,120
63	**Institucionet e sistemit të drejtësisë**	**397,000**	**10,200**	**0**	**10,200**	**407,200**
03320	Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë	10,000	0	0	0	10,000
03330	Veprimtaria e rivlerësimit kalimtar të magjistratit	187,600	4,000	0	4,000	191,600
03340	Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar	134,300	4,700	0	4,700	139,000
03360	Veprimtaria e Komisionerit Publik	65,100	1,500	0	1,500	66,600
66	**Avokati i Popullit**	**123,100**	**2,000**	**0**	**2,000**	**125,100**
03320	Shërbimi i avokatisë	123,100	2,000	0	2,000	125,100
67	**Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**	**55,266**	**2,000**	**0**	**2,000**	**57,266**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	55,266	2,000	0	2,000	57,266
73	**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**	**735,600**	**26,500**	**0**	**26,500**	**762,100**
01610	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	135,600	26,500	0	26,500	162,100
01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	600,000	0	0	0	600,000
76	**Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**	**139,700**	**3,000**	**0**	**3,000**	**142,700**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	139,700	3,000	0	3,000	142,700
77	**Autoriteti i Konkurrencës**	**75,000**	**3,500**	**0**	**3,500**	**78,500**
04120	Mbikëqyrja e tregut dhe garantimi i konkurrencës	75,000	3,500	0	3,500	78,500
82	**Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit**	**11,520**	**1,000**	**0**	**1,000**	**12,520**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	11,520	1,000	0	1,000	12,520
87	**Institucione të tjera qeveritare**	**4,062,967**	**1,533,502**	**293,000**	**1,826,502**	**5,889,469**

Kodi	Emërtimi i institucionit /i programit	Totali i shp. korrente	Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve buxhetore
			Financim i brendshëm	Financimi i huaj	Totali i shp. kapitale	
01320	Shërbime qeveritare	200,000	55,000	0	55,000	255,000
01130	Shërbimi i Prokurimit Publik	81,850	3,000	0	3,000	84,850
01120	Shërbimi për diasporën	117,000	61,000	0	61,000	178,000
05640	Administrimi i ujërave	93,580	16,500	93,000	109,500	203,080
03310	Shërbimi i Avokatisë Shtetërore	183,000	2,000	0	2,000	185,000
01150	Shërbime të tjera	392,822	116,502	0	116,502	509,324
01140	e-Qeverisja	2,534,197	1,116,500	0	1,116,500	3,650,697
01330	Menaxhimi dhe zhvillimi i administratës publike	332,118	162,000	200,000	362,000	694,118
08480	Mbështetje për kultet fetare	128,400	1,000	0	1,000	129,400
88	**Mbështetje për shoqërinë civile**	**123,000**	**1,000**	**0**	**1,000**	**124,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	123,000	1,000	0	1,000	124,000
89	**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**	**68,700**	**16,000**	**0**	**16,000**	**84,700**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	68,700	16,000	0	16,000	84,700
90	**Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik**	**79,100**	**1,000**	**0**	**1,000**	**80,100**
01110	Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik	79,100	1,000	0	1,000	80,100
91	**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi**	**52,300**	**5,000**	**0**	**5,000**	**57,300**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	52,300	5,000	0	5,000	57,300
92	**Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit**	**34,500**	**2,000**	**0**	**2,000**	**36,500**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	34,500	2,000	0	2,000	36,500
95	**Autoriteti për të Drejtën e Informimit**	**59,000**	**2,000**	**0**	**2,000**	**61,000**
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	59,000	2,000	0	2,000	61,000

AKTI NORMATIV NR. 1 2019 - NUMRI I PUNONJËSVE BUXHETORË

Kod min.	Emërtimi i ministrisë/Institucionit buxhetor	AN1 2019
1	Presidenca	86
2	Kuvendi	405
3	Kryeministria	150
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1,929
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1,004
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5,906
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	31,072
12	Ministria e Kulturës	1,002
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	4,257
14	Ministria e Drejtësisë	5,628
15	Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme	565
16	Ministria e Brendshme	14,279
17	Ministria e Mbrojtjes	8,866
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	998
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	139
22	Akademia e Shkencës	29
24	Kontrolli Lartë i Shtetit	196
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1,099
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	50
50	Instituti Statistikës	236
55	Shkolla e Magjistraturës	34
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9
66	Avokati i Popullit	56
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	31
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	71
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	70
77	Autoriteti i Konkurrencës	46
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
90	Komisioni i Prokurimit Publik	36
87	**Institucione të tjera qeveritare**	**1,155**
	Drejtoria Sigurimit të Informacionit Klasifikuar	*38*
	Agjencia e Prokurimit Publik	*44*
	Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	*15*
	Inspektorati Qendror	*21*
	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	*82*
	Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit	*8*
	Agjencia për Diasporën	*15*
	Qendra Botimeve të Diasporës	*15*
	Agjencia për Hapje, Dialog dhe Bashkëqeverisje	*42*
	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	*40*
	Agjencia Kombëtare e Planifikimi të Territorit	*44*
	Agjencia Autonome e Auditimit të Fondeve të BE-së	*21*
	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	*332*
	Agjencia Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA)	*175*
	Komiteti Shtetëror i Kulteve	*10*
	Departamenti i Administratës Publike	*61*
	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	*16*
	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik/Sigurime Kibernetike	*17*
	Sekretariati Teknik i KEK-së	*6*
	Autoriteti Shtetëror Gjeohapësinor (ASIG)	*46*

Kod min.	Emërtimi i ministrisë/Institucionit buxhetor	AN1 2019
	Avokatura e Shtetit	*107*
88	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	***16***
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	***37***
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	***34***
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	***19***
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet ish-Sigurimit	***40***
	Institucione të Sistemit të Drejtësisë	**2,825**
28	Prokuroria e Përgjithshme	*928*
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	*1,493*
30	Gjykata Kushtetuese	*62*
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	*65*
41	Institucionet e SPAK-ut dhe BKH-së	*100*
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	*0*
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	*64*
63	Kolegji i Posaçëm i Apelimit	*43*
63	Komisioneri Publik	*30*
63	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	*40*
	Total punonjës buxhetore	**82,381**
	Rezervë për institucione të qeverisjes qendrore	*24*
	Rezervë për institucionet e drejtësisë	*50*
	TOTAL, NUMRI I PUNONJËSVE	**82,455**

ANEKSI 3
FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE DHE PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE RAJONALE

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

2. Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.

3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin	kryetar
2. Zëvendëskryeministrin	zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
6. Ministrin e Kulturës	anëtar;
7. Ministrin e Brendshëm	anëtar;
8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
10. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:

a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;

b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;

5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në nëntor të vitit paraardhës.

7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrisë.

9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi buxhetor për infrastrukturën vendore dhe rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor 2019–2021 në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Autoriteti programues, kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve, si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja miratohen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit administron nevojat dhe propozimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, qendrore dhe aktorë të tjerë (përfshirë FSHZH-në dhe njësitë e zhvillimit rajonal të tij) që konsistojnë në projekte në interes dhe në funksion të zhvillimit lokal e rajonal, përfshirë edhe projekte zhvillimore me natyrë ekonomike, të zbatuara në partneritet midis FSHZH-së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera.

Nga fondi për infrastrukturën vendore dhe rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve - Infrastruktura vendore dhe rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit të programimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së zbatimit miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar.

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2015–2020
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2015–2020

Në milion lekë (in million lek)

Nr.	Emërtimi	Faktik 2016	Në % të PBB-së	Faktik 2017	Në % të PBB-së	Akti normativ 2018	Në % të PBB-së	Akti normativ 2019	Në % të PBB-së	Buxheti 2020	Në % të PBB-së	Buxheti 2021	Në % të PBB-së	I T E M S
	TOTALI I TË ARDHURAVE	**407,021**	**27.6%**	**430,397**	**27.7%**	**464,703**	**28.2%**	**486,677**	**28.3%**	**518,716**	**27.8%**	**555,129**	**27.8%**	**TOTAL REVENUE**
I	**Të ardhura nga ndihmat**	**14,639**	**1.0%**	**11,085**	**0.7%**	**14,500**	**0.9%**	**15,500**	**0.9%**	**15,500**	**0.8%**	**15,500**	**0.8%**	**Grants**
	Nga të cilat: mbështetje buxhetore	*0*	*0.0%*	*2,738*	*0.2%*	*2,500*	*0.2%*	*2,500*	*0.1%*	*2,500*	*0.1%*	*2,500*	*0.1%*	*from which: Budget Support*
II	**Të ardhura tatimore**	**369,884**	**25.1%**	**398,629**	**25.7%**	**424,446**	**25.8%**	**448,337**	**26.1%**	**478,911**	**25.6%**	**514,756**	**25.7%**	**Tax Revenue**
II.1	**Nga tatimet dhe doganat**	**275,780**	**18.7%**	**293,386**	**18.9%**	**313,097**	**19.0%**	**323,604**	**18.8%**	**349,369**	**18.7%**	**376,198**	**18.8%**	**From tax offices and customs**
	Tatimi mbi vlerën e shtuar	131,390	8.9%	139,541	9.0%	148,134	9.0%	151,314	8.8%	164,908	8.8%	177,958	8.9%	V.A.T
	Tatimi mbi fitimin	29,151	2.0%	31,645	2.0%	33,823	2.1%	33,500	2.0%	35,976	1.9%	38,769	1.9%	Profit Tax
	Akcizat	41,896	2.8%	45,105	2.9%	49,000	3.0%	48,300	2.8%	51,716	2.8%	55,675	2.8%	Excise Tax
	Tatimi mbi të ardhurat personale	31,412	2.1%	32,102	2.1%	36,800	2.2%	41,900	2.4%	44,818	2.4%	48,106	2.4%	Personal Income Tax
	Taksa nacionale dhe të tjera	35,794	2.4%	38,502	2.5%	38,340	2.3%	41,200	2.4%	44,070	2.4%	47,255	2.4%	National Taxes and others
	Taksa doganore	6,137	0.4%	6,492	0.4%	7,000	0.4%	7,390	0.4%	7,881	0.4%	8,434	0.4%	Customs Duties
II.2	**Të ardhura nga pushteti vendor**	**14,951**	**1.0%**	**18,447**	**1.2%**	**18,787**	**1.1%**	**25,661**	**1.5%**	**24,167**	**1.3%**	**25,862**	**1.3%**	**Local Taxes**
	Taksa lokale	9,675	0.7%	13,273	0.9%	10,345	0.6%	18,106	1.1%	16,110	0.9%	17,240	0.9%	Local Taxes
	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	4,678	0.3%	4,879	0.3%	8,139	0.5%	6,915	0.4%	7,374	0.4%	7,891	0.4%	Property Tax
	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	598	0.0%	296	0.0%	302	0.0%	640	0.0%	683	0.0%	731	0.0%	Simple profit tax of small bisness
II.3	**Të ardhurat nga fondet speciale**	**79,153**	**5.4%**	**86,795**	**5.6%**	**92,562**	**5.6%**	**99,071**	**5.8%**	**105,375**	**5.6%**	**112,696**	**5.6%**	**Revenues from Special Funds**
	Sigurimi shoqëror	66,688	4.5%	73,999	4.8%	78,536	4.8%	84,342	4.9%	89,733	4.8%	96,028	4.8%	Social Insurance
	Sigurimi shëndetësor	10,820	0.7%	11,602	0.7%	12,526	0.8%	13,729	0.8%	14,642	0.8%	15,669	0.8%	Health insurance
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,645	0.1%	1,194	0.1%	1,500	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.0%	Revenues for owners' in value-compensation
III	**Të ardhura jotatimore**	**22,498**	**1.5%**	**20,683**	**1.3%**	**25,757**	**1.6%**	**22,840**	**1.3%**	**24,305**	**1.3%**	**24,873**	**1.2%**	**Nontax Revenue**
	Tran. fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,095	0.1%	908	0.1%	1,000	0.1%	600	0.0%	1,000	0.1%	1,000	0.0%	Profit transfer from BOA
	Të ardhura nga institucionet buxhetore	15,001	1.0%	13,694	0.9%	15,977	1.0%	13,830	0.8%	14,000	0.7%	14,500	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	83	0.0%	178	0.0%	800	0.0%	620	0.0%	845	0.0%	863	0.0%	Divident
	Tarifat e Shërbimeve	2,738	0.2%	2,332	0.2%	3,400	0.2%	3,080	0.2%	3,500	0.2%	3,520	0.2%	Services Fees
	Të tjera	3,581	0.2%	3,570	0.2%	4,580	0.3%	4,710	0.3%	4,960	0.3%	4,990	0.2%	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**433,697**	**29.4%**	**461,410**	**29.7%**	**497,069**	**30.2%**	**519,577**	**30.3%**	**548,559**	**29.3%**	**578,295**	**28.9%**	**TOTAL EXPENDITURE**
I	**Shpenzime korrente**	**368,720**	**25.0%**	**382,287**	**24.6%**	**408,778**	**24.8%**	**428,719**	**25.0%**	**450,496**	**24.1%**	**475,010**	**23.7%**	**Current Expenditures**
1	**Personeli**	**67,540**	**4.6%**	**72,642**	**4.7%**	**77,855**	**4.7%**	**80,557**	**4.7%**	**82,973**	**4.4%**	**85,473**	**4.3%**	**Personnel expenditures**
	Paga	58,215	3.9%	62,581	4.0%	64,781	3.9%	65,651	3.8%	68,209	3.6%	70,209	3.5%	Wages
	Kontributi për sigurime shoqërore	9,325	0.6%	10,061	0.6%	11,074	0.7%	11,006	0.6%	11,764	0.6%	12,264	0.6%	Social insurance contributions
	Fondi i veçantë i pagave				0.0%	500	0.0%	400	0.0%	500	0.0%	500	0.0%	Bonus fund
	Politika të reja pagash				0.0%	0	0.0%	2,000	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.0%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta					1,500	0.1%	1,500	0.1%	1,500	0.1%	1,500	0.1%	Higher Education from its own revenues
2	**Interesat**	**36,259**	**2.5%**	**31,904**	**2.1%**	**41,500**	**2.5%**	**40,100**	**2.3%**	**47,538**	**2.5%**	**52,978**	**2.6%**	**Interest**
	Të brendshme	25,526	1.7%	21,415	1.4%	25,000	1.5%	23,100	1.3%	28,238	1.5%	31,278	1.6%	Domestic
	Të huaja	10,733	0.7%	10,489	0.7%	12,500	0.8%	12,700	0.7%	12,300	0.7%	13,700	0.7%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit				0.0%	4,000	0.2%	4,300	0.3%	7,000	0.4%	8,000	0.4%	Contingency for debt related risks
3	**Shpenzime operative mirëmbajtjeje, nga të cilat:**	**44,329**	**3.0%**	**43,441**	**2.8%**	**46,327**	**2.8%**	**48,019**	**2.8%**	**48,941**	**2.6%**	**50,948**	**2.5%**	**Operational & Maintenance of which:**
	Të qeverisjes qendrore		*0.0%*		*0.0%*	*42,527*	*2.6%*	*44,019*	*2.6%*	*44,641*	*2.4%*	*46,548*	*2.3%*	*Central government*
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta		*0.0%*		*0.0%*	*1,800*	*0.1%*	*1,900*	*0.1%*	*2,000*	*0.1%*	*2,100*	*0.1%*	*from revenues of Higher Education System*
	Të tjera jashtë limitit		*0.0%*		*0.0%*	*2,000*	*0.1%*	*2,100*	*0.1%*	*2,300*	*0.1%*	*2,300*	*0.1%*	*from Exceptional Revenues*
4	**Subvencionet**	**1,725**	**0.1%**	**2,310**	**0.1%**	**2,090**	**0.1%**	**1,430**	**0.1%**	**1,490**	**0.1%**	**1,490**	**0.1%**	**Subsidies**
5	**Shpenzime për fondet speciale**	**152,591**	**10.3%**	**162,145**	**10.4%**	**172,485**	**10.5%**	**178,987**	**10.4%**	**191,185**	**10.2%**	**201,391**	**10.1%**	**Social insurance outlays**
	Sigurime shoqërore	114,276	7.7%	119,081	7.7%	123,515	7.5%	129,637	7.6%	138,965	7.4%	145,965	7.3%	Social insurance
	Politika të reja pensionesh		0.0%		0.0%	1,570	0.1%	2,450	0.1%	2,520	0.1%	2,620	0.1%	Contingency for new pension policies
	Bonusi i pensionistëve					3,000	0.2%							Pensioners' Bonus
	Sigurime Shëndetësore	34,796	2.4%	39,090	2.5%	40,400	2.5%	41,900	2.4%	44,200	2.4%	47,306	2.4%	Health insurance
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	3,519	0.2%	3,974	0.3%	4,000	0.2%	5,000	0.3%	5,500	0.3%	5,500	0.3%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	**Shpenzime për buxhetin vendor**	**43,580**	**3.0%**	**46,487**	**3.0%**	**46,221**	**2.8%**	**55,286**	**3.2%**	**53,869**	**2.9%**	**57,129**	**2.9%**	**Local Budget expenditure**
	Transfertat nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor	28,629	0.0%	28,039	1.8%	24,034	1.5%	25,075	1.5%	26,032	1.4%	27,467	1.4%	Central Government Grant for Local Government
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme				*0.0%*	*16,580*	*1.0%*	*17,632*	*1.0%*	*18,600*	*1.0%*	*20,000*	*1.0%*	*Unconditional Fund*
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant specifik)				*0.0%*	*7,454*	*0.5%*	*7,443*	*0.4%*	*7,432*	*0.4%*	*7,467*	*0.4%*	*Specific Grant*
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	14,951	1.0%	18,447	1.2%	18,787	1.1%	25,661	1.5%	24,167	1.3%	25,862	1.3%	Local Budget (Own revenues)

Nr.	Emërtimi	Faktik 2016	Në % të PBB-së	Faktik 2017	Në % të PBB-së	Akti normativ 2018	Në % të PBB-së	Akti normativ 2019	Në % të PBB-së	Buxheti 2020	Në % të PBB-së	Buxheti 2021	Në % të PBB-së	I T E M S
	Taksa të ndara		0.0%		0.0%	600	0.0%	650	0.0%	670	0.0%	700	0.0%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jotatimore)		0.0%		0.0%	2,800	0.2%	2,900	0.2%	3,000	0.2%	3,100	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor							1,000						
7	**Shpenzime të tjera**	**22,696**	**1.5%**	**23,357**	**1.5%**	**22,300**	**1.4%**	**24,340**	**1.4%**	**24,500**	**1.3%**	**25,600**	**1.3%**	**Other expenditures**
	Pagesa e papunësisë	691	0.0%	346	0.0%	500	0.0%	540	0.0%	600	0.0%	600	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma ekonomike dhe paaftësia	20,026	1.4%	20,714	1.3%	20,500	1.2%	20,800	1.2%	20,900	1.1%	21,000	1.0%	Social assistance and disability
	Kompensim për ish-të përndjekurit politikë	1,979	0.1%	2,298	0.1%	1,000	0.1%	1,200	0.1%	1,000	0.1%	1,000	0.0%	Compensation for ex political prisoners
	Shpërblimi i familjeve në nevojë					300	0.0%							Compensation for vulnerable families
	Bonusi i lindjeve							1,800	0.1%	2,000	0.1%	3,000	0.1%	Birth Bonus
II	**Fondi Rezervë**	**0**	**0.0%**	**0**	**0.0%**	**2,600**	**0.2%**	**3,350**	**0.2%**	**4,000**	**0.2%**	**5,100**	**0.3%**	**Reserve fund, Contingency**
	Fondi rezervë		0.0%		0.0%	1,800	0.1%	2,000	0.1%	1,500	0.1%	2,500	0.1%	Reserve Fund
	Rezervë për reformën në Drejtësi		0.0%		0.0%	800	0.0%	1,350	0.1%	2,500	0.1%	2,600	0.1%	Contingency for deficit financing
III	**Shpenzime kapitale**	**59,478**	**4.0%**	**68,455**	**4.4%**	**86,691**	**5.3%**	**87,508**	**5.1%**	**94,063**	**5.0%**	**98,185**	**4.9%**	**Capital expenditures**
	Financimi i brendshëm	39,118	2.7%	46,177	3.0%	55,424	3.4%	54,808	3.2%	57,945	3.1%	60,325	3.0%	Domestic financing
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë				0.0%	700	*0.0%*	1,100	0.1%	1,200	0.1%	1,300	0.1%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi i huaj	20,360	1.4%	22,278	1.4%	30,567	1.9%	31,600	1.8%	34,918	1.9%	36,560	1.8%	Foreign financing
	nga të cilat: Energjia					*5,000*	*0.3%*	*2,500*	*0.1%*	*3,000*	*0.2%*	*3,000*	*0.1%*	*from which: Energy*
V	**Huadhënie neto për energjinë**	**5,499**	0.4%	**9,217**	0.6%	**-1,000**	*-0.1%*							**Net Lending for Energy Support**
	Hua e dhënë për energjinë													Borrowing to Energy Sector
	Hua e kthyer nga sistemi energjetik					-1,000	*-0.1%*							Repayment from Energy Sector
VI	**Fond shpronësimi**			**1,450**	0.1%									Expropriation Fund
	Deficiti	**-26,676**	**-1.8%**	**-31,012**	**-2.0%**	**-32,366**	**-2.0%**	**-32,900**	**-1.9%**	**-29,843**	**-1.6%**	**-23,165**	**-1.2%**	**Cash Balance**
	Financimi i deficitit të	**26,676**	**1.8%**	**31,012**	**2.0%**	**32,366**	**2.0%**	**32,900**	**1.9%**	**29,843**	**1.6%**	**23,165**	**1.2%**	**Financing (Cash)**
	bredshëm	**9,176**	**0.6%**	**1,899**	**0.1%**	**41,447**	**2.5%**	**49,697**	**2.9%**	**13,177**	**0.7%**	**40,665**	**2.0%**	**Domestic**
	Të ardhura nga privatizimi	2,805	0.2%	418	0.0%				0.0%					Privatization receipts
	Huamarrje e brendshme	10,602	0.7%	16,285	1.0%	29,947	1.8%	24,000	1.4%	22,900	1.2%	22,900	1.1%	Domestic borrowing
	Të tjera	-4,231		-14,804		11,500	0.7%	25,697	1.5%	-9,723	-0.5%	17,765	0.9%	Other
	I huaj	**17,500**	**1.2%**	**29,113**	**1.9%**	**-9,081**	**-0.6%**	**-16,797**	**-1.0%**	**16,666**	**0.9%**	**-17,500**	**-0.9%**	**Foreign**
	Hua afatgjatë (e marrë)	18,780	1.3%	23,407	1.5%	19,010	1.2%	18,600	1.1%	84,918	4.5%	23,560	1.2%	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-408	0.0%	169	0.0%									Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-21,998	-1.5%	-25,769	-1.7%	-35,091	-2.1%	-35,397	-2.1%	-68,252	-3.7%	-41,060	-2.1%	Repayments
	Mbështetje buxhetore	21,126	1.4%	31,306	2.0%	7,000	0.4%							Budget support
	Produkti i Brendshëm Bruto (PBB)	***1,475,251***	***100%***	***1,552,868***	***100%***	***1,647,625***	***100%***	***1,717,000***	***100.0%***	***1,869,208***	***100.0%***	***2,000,323***	***100.0%***	***Gross Domestic Product (GDP)***

AKT NORMATIV
Nr. 3, datë 2.10.2019

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas pikës 8, të nenit 27, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

"9. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile.

Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 36/1
Dispozitë tranzitore

Personat që aplikojnë për t'u pajisur me leje për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e tërmetit të datës 21 shtator 2019, përjashtohen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.".

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 626, datë 18.9.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 651, DATË 10.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 102/2014, "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 18, 19, 24, 26, 29, 35, 39 deri 42, 47, 51, 58, 62, 64, 71, 83, 94, 98, 100, 108, 115, 118, 119, pika 7, 123, 129, 133, 141, 145, 148, 149 deri 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 154, 160 deri 169, 174 deri 177, 181, 184, 188, 190, 193, 194, 196, 200, 202, 206, 209, 212, 216, 226, 238, 240, 245, 248, 284, 286, 287 e 288, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në titullin VII, kreu III, seksionet 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë vijon:

"Seksioni 3
Zonat e lira doganore

Neni 648–1
Kushtet e përgjithshme të funksionimit
(Nenet 210 deri 222, të Kodit)

1. Në përputhje me dispozitat e këtij seksioni, dispozitat lidhur me regjimin e magazinimit doganor, të referuara në këtë vendim, zbatohen edhe për qëllime të këtij seksioni.

2. Çdo person juridik, i themeluar në Republikën e Shqipërisë, i cili, në bazë të një titulli të ligjshëm, posedon pronën brenda perimetrit të miratuar të zonës së lirë doganore (në vijim, zona) ka të drejtë të aplikojë për administrimin e një zone, me cilësinë e administratorit të zonës, me kusht që të përmbushë kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në këtë vendim e në legjislacionin në fuqi.

3. Autorizimi për administrimin e zonës miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

4. Administratori i zonës është përgjegjës për funksionimin e zonës.

Neni 648–2
Aktivitetet në zonë
(Nenet 199, 217, 219 dhe 220 të Kodit)

1. Në zonë kryhen këto aktivitete:

a) magazinimi i mallrave joshqiptare deri në caktimin e një regjimi për to;

b) magazinimi i mallrave shqiptare, të cilat mund të hyjnë, të lëvizin, të përdoren, të përpunohen ose të konsumohen në një zonë. Në këto raste mallrat nuk konsiderohen sikur janë nën regjimin e zonës;

c) përpunime nën regjime të posaçme doganore;

ç) çdo transaksion që lidhet me tregtimin e mallrave joshqiptare;

d) furnizime *duty free*, furnizime bordesh;

dh) operacione përzierjeje (*blending*) për produkte të veçanta sipas kërkesës së klientëve dhe të tregjeve;

e) logjistikë tregtare, operacione seleksionimi dhe përshtatjeje sipas kërkesave të tregjeve;

ë) ambalazhim, paketim, etiketim dhe vendosje shenjash identifikimi, pullash fiskale apo tregtare;

f) përpunime të çfarëdolloji, sipas aneksit 71–03, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

g) depozitim mallrash si garanci kontraktuale për operacionet tregtare;

gj) transbordim i mallrave;

h) furnizime/transferime nga anija/mjeti në anije/mjet, nga magazina në magazinë, nga magazina në anije/mjet dhe nga anija/mjeti në magazinë.

2. Aktivitetet në zonë miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Kërkesa për miratim aktiviteti në zonë paraqitet nga administratori i zonës sipas modelit në aneksin 16, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Çdo aktivitet në zonë kodifikohet sipas metodikës që administratori i zonës ka zgjedhur për efekte regjistrimi e inventarizimi.

3. Miratimi i aktivitetit në zonë bëhet sipas aneksit 17, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Me miratimin e aktivitetit, administratori i zonës regjistron llojin e aktivitetit të miratuar në sistem. Për çdo aktivitet të miratuar, administratori i zonës harton rregulloren e funksionimit të aktivitetit dhe ia paraqet për miratim drejtorit të Përgjithshëm i Doganave, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të aktivitetit.

4. Nëse nga përpunimi i mallrave nën regjimin e zonës ndryshojnë parametrat fizikë, kimikë, pesha, densiteti, madhësia ose forma e ambalazhimit, detyrimisht për këto procese, operatori duhet të mbajë regjistër të detajuar dhe, njëkohësisht, për një periudhë 3-vjeçare, kopje të kartave teknike, ditarëve të prodhimit, certifikatave ose analizave përkatëse, në funksion të kontrollit dhe mbikëqyrjes doganore. Nëse cikli i prodhimit zgjat më shumë se 24 (njëzet e katër) orë, transferimi i produkteve në regjistrat e inventarit nga objekti në objekt bëhet çdo ditë në orën 08:00.

5. Mallrat e përftuara nga këto operacione mund të pajisen me certifikatë origjine, në të cilën detyrimisht shënohet zona e lirë. Në varësi të kushteve të përmbushura certifikata mund të jetë edhe preferenciale.

6. Transbordi/transferimi i mallrave bëhet vetëm ndërmjet objekteve që janë miratuar për këtë aktivitet. Çdo mjet ku kryhet transbord do të regjistrohet si operator me të gjitha të dhënat përkatëse në regjistër, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 648-4, të këtij vendimi. Në rast se transbordi kryhet nga anija/mjeti në anije/mjet, zyra doganore njoftohet jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) orë para kryerjes së saj.

Neni 648–3
Zyra/Personeli doganor
(Nenet 7 dhe 8 të Kodit)

Në përputhje me nenet 7 dhe 8 të Kodit, për funksionimin e zonës krijohet struktura përkatëse me personel doganor të mjaftueshëm për kryerjen e

formaliteteve doganore dhe bashkëpunimin me administratorin dhe operatorët në zonë.

Administratori vë në dispozicion ambientet dhe krijon kushtet e punës e të pajisjeve për funksionimin e zyrës.

Nenit 648–4
Regjistrat e zonës
(Nenet 17 dhe 194 të Kodit)

1. Çdo hyrje, dalje ose përpunim në zonë shënohet në regjistrat e zonës për efekte kontrolli dhe mbikëqyrjeje doganore. Administratori i zonës harton formën dhe rregulloren e plotësimit të regjistrave dhe ia paraqet për miratim drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, i cili, kur i gjen në përputhje me parashikimet e Kodit dhe të dispozitave zbatuese të tij, si dhe jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e paraqitjes, i miraton ato.

2. Regjistrat do të jenë elektronikë e funksionalë në kohë reale për të gjithë operatorët dhe autoritetin doganor, sipas përcaktimeve të neneve 3, 4, 5 e 6, të këtij vendimi. Teknologjia e ndërtimit të regjistrave elektronikë duhet të jetë fleksibël për ndërveprim me sisteme të tjera përmes shkëmbimit të mesazheve. Regjistrat duhet të kenë të paktën një *back up* sipas standardit. Komunikimi në çdo post pune apo kontrolli të regjistrave duhet të jetë i sigurt.

Neni 648–5
Hyrja e mallrave shqiptare ose joshqiptare në zonë
(Nenet 218, 219 e 220 të Kodit)

1. Mallrat joshqiptare hyjnë në rrugë tokësore, si më poshtë vijon:

a) mallrat nën regjimin e zonës hyjnë në rrugë tokësore drejtpërsëdrejti (në rastet kur shtrirja e zonës kufizohet nga kufij tokësorë të Republikës së Shqipërisë) ose përmes mbylljes së një regjimi të posaçëm doganor;

b) pas kryerjes së formaliteteve doganore, që lidhen me mbylljen e regjimit për mallrat, bëhet futja e tyre në zonë përmes regjistrimeve në regjistrat përkatës. Pjesë e këtij regjistrimi do të jetë edhe numri i regjimit paraardhës që ka përfunduar, për të vijuar më tej me hyrjen në zonë.

2. Mallrat joshqiptare hyjnë në rrugë detare, si më poshtë vijon:

a) mallrat futen në zonë pasi janë kryer formalitetet doganore. Para futjes së mallrave bëhet regjistrimi i tyre në regjistër në bazë të të dhënave që ka manifesti apo dokumenti i transportit (*Bill of Lading / BL*). Me përfundimin e futjes së mallrave në objekt, operatori bën inventarizimin e tyre dhe, nëse konstaton diferenca në sasi ndërmjet gjendjes faktike të mallrave dhe gjendjes sipas manifestit apo dokumentit të transportit, mban një procesverbal konstatimi, i cili nënshkruhet nga të gjithë personat përgjegjës për futjen e inventarizimin e mallrave në objekt, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e miratuar, sipas pikës 2, të nenit 648-9, të këtij vendimi. Procesverbali i njoftohet menjëherë zyrës doganore përgjegjëse e cila kryen verifikimet përkatëse dhe, nëse i çmon të nevojshme, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, mund të fillojë një hetim;

b) pas njoftimit të doganës dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga mbajtja e procesverbalit, operatori bën pasqyrimin në regjistër të diferencave të konstatuara.

3. Procedurat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, zbatohen edhe në rastin e hyrjes së mallrave në objekt nëpërmjet instalimeve fikse të transportit.

4. Mallrat shqiptare hyjnë në një zonë, sipas përcaktimit në nenin 219, të Kodit. Për qëllim të formaliteteve doganore, mallrat shqiptare që hyjnë në një zonë të lirë nuk regjistrohen në regjistrat e administrimit të regjimit të zonës së lirë. Këto mallra magazinohen dhe regjistrohen më vete dhe janë lehtësisht të identifikueshme për autoritetet doganore.

Nenit 648–6
Dalja e mallrave shqiptare ose joshqiptare nga zona
(Nenet 221 dhe 241 të Kodit)

1. Mallrat joshqiptare dalin nga regjimi i zonës në rrugë tokësore, si më poshtë vijon:

a) mallrat joshqiptare dalin nga regjimi i zonës detyrimisht duke caktuar një regjim doganor për to;

b) operatori detyrimisht duhet të depozitojë deklaratën doganore për regjimin doganor të kërkuar dhe, pas pranimit të saj, kryen regjistrimet e daljes në regjistrat e magazinës, duke shënuar dhe numrin e deklaratës përkatëse.

2. Mallrat joshqiptare dalin nga regjimi i zonës në rrugë detare, si më poshtë vijon:

a) për mallrat që dalin në rrugë detare, jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) orë para nisjes së operacionit, operatori/administratori njofton zyrën doganore për orën e saktë kur do të nisë dalja e mallrave. Autoriteti doganor i zyrës që mbikëqyr zonën, në përputhje me rrethanat dhe bazuar në analizën e riskut, kryen kontroll ose mbikëqyrje doganore. Forma dhe procedura e dërgimit të njoftimit caktohet nga struktura doganore përgjegjëse dhe i njoftohet administratorit të zonës. Forma dhe procedura për njoftimin e daljes së mallrave është e njëjtë për të gjithë operatorët që ushtrojnë veprimtarinë në zonë;

b) pas përfundimit të daljes së mallrave nga objekti dhe të procedurës përkatëse me anijen detare, operatori plotëson regjistrat e magazinës, duke shënuar numrin e manifestit apo të dokumentit të transportit (*Bill of Lading / BL*). Në çdo rast, një kopje e dokumenteve të përcaktuara në këtë pikë ruhet nga operatori për të paktën 3 (tre) vjet.

3. Mallrat shqiptare që dalin nga zona, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, vendosen nën regjimin e eksportit.

Neni 648–7

Aplikimi për administrimin e një zone të lirë doganore

(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

1. Aplikimi për administrimin e një zone paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Aplikimi bëhet me shkrim, sipas aneksit 14, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Aplikimit i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtme:

a) pasqyrat financiare të shoqërisë për 3 (tri) vitet e fundit, akti i themelimit dhe statuti i saj, si dhe ekstrakti i regjistrit tregtar të lëshuar jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit;

b) akti i disponimit për ambientin/godinën që do të përdoret për këtë qëllim;

c) vërtetimi që aplikuesi, përfaqësuesi ligjor, anëtarët e këshillit të administrimit ose të këshillit mbikëqyrës, ortakët/aksionarët, punonjësi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore dhe personeli kyç, që është përcaktuar të operojë në zonën e lirë doganore, sipas planit të organizimit të punës, në 5 (pesë) vitet e fundit nga data e paraqitjes së aplikimit, nuk kanë detyrime doganore të papaguara dhe nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë ose nuk janë në ndjekje penale për njërën nga veprat penale në fushën e doganave;

ç) plani i organizimit të punës dhe lista e personelit kyç që do të operojë në zonën e lirë doganore e do të ndjekë zbatimin e këtij plani;

d) akti noterial që provon se aplikuesi gëzon besimin dhe autorizimin e pronarëve apo personave që kanë të drejtën e disponimit të pronave brenda perimetrit të miratuar të zonës;

dh) lista e mjeteve që disponon operatori për plotësimin e nevojave të ushtrimit të aktivitetit e që lidhen me trajtimet, përpunimet, matjet, transportin, kontrollin, ruajtjen dhe sigurinë;

e) numri dhe emërtimi i dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës.

4. Dokumentet e mësipërme paraqiten në formë shkresore në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, si dhe në formë elektronike. Përveç dokumenteve të mësipërme, aplikuesi duhet të paraqesë edhe çdo dokument tjetër nëpërmjet të cilit provon përmbushjen e kritereve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe të rrethanave/fakteve të parashtruara në aplikimin e tij e që është i nevojshëm për vlerësimin e aplikimit.

Neni 648–8

Procedurat e miratimit të autorizimit për administrimin e zonës

(Nenet 27, pika 1, dhe 217, të Kodit)

1. Me marrjen e aplikimit, struktura përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në bashkëpunim me degën doganore mbikëqyrëse, verifikon informacionin e paraqitur. Kur konstatohet se aplikimi nuk përmban të gjitha të dhënat/dokumentet/informacionet e kërkuara, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit, i kërkohet aplikuesit të plotësojë të dhënat/ dokumentet/ informacionet e nevojshme, duke i paraqitur edhe shkaqet e kërkesës për plotësimin e dokumentacionit. Aplikuesi plotëson informacionin e kërkuar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kësaj kërkese. Mosplotësimi i

të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës.

2. Dega doganore mbikëqyrëse, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e konstatimit se plotësohen të gjitha kushtet dhe dokumentacioni/informacionet e lartpërmendura, kryen verifikimin e përputhshmërisë së dokumentacionit të paraqitur me gjendjen reale, si dhe me këqyrjen në vend të vendndodhjes/ambienteve për të cilat kërkohet autorizimi.

3. Në rast se nga dega mbikëqyrëse doganore ose Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konstatohet se janë paraqitur rrethana të rreme ose janë fshehur fakte të vërteta, drejtori i Përgjithshëm i Doganave vendos refuzimin e aplikimit. Në rastet kur vlerësohet se paraqitja e rrethanave të rreme ose fshehja e fakteve të vërteta përbën vepër penale, nëpunësi publik përgjegjës bën kallëzimin me shkrim, sipas parashikimeve të nenit 281, të Kodit të Procedurës Penale.

4. Kur konstatohen parregullsi, i kërkohet aplikuesit që të plotësojë apo të rregullojë situatën, duke marrë masat e duhura brenda një periudhe kohore prej 10 (dhjetë) ditësh.

5. Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procesit të verifikimit apo nga rregullimi i situatës, dega doganore mbikëqyrëse përcjell në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave një relacion, ku sqarohet në mënyrë të detajuar e gjithë procedura e ndjekur deri në këtë moment, si edhe përfundimi i verifikimeve të kryera.

6. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave konstaton se aplikimi është i rregullt dhe në përputhje me kushtet e kërkesat e këtij vendimi dhe me legjislacionin doganor në fuqi, miraton autorizimin për administrimin e zonës, sipas aneksit 15, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Autorizimi për administrimin e zonës së lirë doganore mund të pezullohet, shfuqizohet ose anulohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke zbatuar *mutatis mutandis* përcaktimet e neneve 648–12 deri 648–17, të këtij vendimi.

Neni 648–9

Përgjegjësitë dhe detyrimet e administratorit të zonës

(Nenet 28 dhe 217, të Kodit)

1. Administratori i zonës ka këto përgjegjësi:

a) rrethon dhe mirëmban zonën, së paku me gardh metalik të qëndrueshëm me bazament solid, në një lartësi jo më pak se 2 (dy) metra;

b) përgjigjet për sigurinë dhe paprekshmërinë e zonës përmes shërbimit të rojeve fizike dhe grupit të gatshëm për zgjidhjen e emergjencave;

c) krijon dhe mban regjistrimet e zonës sipas përcaktimeve të nenit 194, të Kodit Doganor;

ç) mirëmban dhe siguron mbrojtjen e regjistrave të nevojshëm për funksionimin e zonës;

d) mban përgjegjësi për mallrat, sipas përcaktimeve të nenit 215, të Kodit Doganor;

dh) është përgjegjës për marrëdhënie të drejta e korrekte ndërmjet punonjësve, operatorëve të zonës së lirë dhe doganës;

e) siguron lejet, licencat, aktin e kolaudimit apo të kalibrimit, lejen mjedisore dhe dokumente të tjera që vërtetojnë plotësimin e kushtëzimeve të përcaktuara në këtë vendim e në legjislacionin në fuqi, që rregullon fusha të veçanta e që mbulojnë aktivitetin e kërkuar;

ë) siguron mundësinë për mbyllje me dry ose plumbosje nga autoritetet doganore të ambienteve, godinave, instalimeve etj.;

f) siguron aparaturat matëse, që mundësojnë verifikimin fizik të sasisë gjendje, në çdo moment që do të kërkohet nga autoritetet doganore, si edhe ndarjen e mallrave sipas statusit të tyre;

g) është përgjegjës për kryerjen e të gjitha procedurave për autorizimin e objekteve dhe të veprimtarive të operatorëve në zonë, sipas aplikimit të përcaktuar në anekset 16 e 18, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Miratimi i këtyre aplikimeve bëhet sipas anekseve 17 e 19, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, duke zbatuar "mutatis mutandis" procedurat e përcaktuara në nenin 648-8, të këtij vendimi.

2. Administratori i zonës ka detyrimet e mëposhtme:

a) harton rregulloren e operatorëve që do të operojnë në zonë;

b) regjistron operatorët e zonës, i pajis me kod identifikimi për kryerjen e aktivitetit në një objekt dhe për një veprimtari të autorizuar;

c) informon zyrtarisht me shkrim, pa vonesë, zyrën doganore mbikëqyrëse, nëse konstaton mospërputhje ndërmjet regjistrit elektronik dhe

gjendjes që disponon operatori apo për çdo rast konstatimi të shkeljeve të tjera në zonë;

ç) siguron sistemin e monitorimit me videokamera dhe të ndriçimit për qëllime mbikëqyrjeje e kontrolli nga autoritetet doganore;

d) bën ndriçimin e ambienteve dhe të rrethimit, si dhe instalimin, vendosjen, mirëmbajtjen, furnizimin me energji të pandërprerë etj. të sistemeve mbikëqyrëse me videokamera dhe siguron transmetimin on-line dhe ruajtjen e pacenuar të imazheve të regjistruara nga sistemet mbikëqyrëse me videokamera, sipas vendeve dhe këndeve të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Sistemi i ndriçimit dhe i videokamerave duhet të mundësojë kontrollin e perimetrit të jashtëm të zonës së lirë doganore, si dhe ambienteve të brendshme të tyre. Administratori siguron ruajtjen e imazheve për një periudhë të paktën prej 3 (tre) muajsh. Në rast se ka filluar procedura hetimore/gjyqësore, këto imazhe ruhen deri në përfundim të procesit hetimor dhe/ose gjyqësor;

dh) vendos në dispozicion të autoriteteve doganore ambientet e punës, të cilat duhet të plotësojnë standardet e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si dhe mjetet e nevojshme për të kryer kontrollet;

e) informon zyrtarisht me shkrim dhe pa vonesë zyrën doganore mbikëqyrëse, nëse konstaton mospërputhje mes stokut faktik në zonën e lirë doganore dhe stokut sipas sistemit elektronik doganor;

ë) bashkëpunon me zyrën mbikëqyrëse doganore të zonës së lirë doganore për funksionimin e saj sipas orarit të miratuar, duke bërë edhe kërkesat për ndryshimin e tij, duke e shoqëruar edhe me dokumentacionin e nevojshëm për pagesat e punonjësve doganorë, sipas vendimit nr.921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar;

f) merr aprovimin paraprak nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për çdo ndryshim strukturor në ambientet e autorizuara;

g) siguron që të gjitha hyrjet/daljet në dhe nga zona e lirë të jenë të sigurta.

Neni 648–10

Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit

(Nenet 28 dhe 217 të Kodit)

1. Operatori ka detyrimet e mëposhtme:

a) zbaton me korrektësi legjislacionin doganor;

b) zbaton me korrektësi statutin dhe rregulloret e zonës;

c) merr masat për ruajtjen, përpunimin dhe trajtimin sipas rregullave dhe normave të sigurisë së mallrave që ka në objektet që administron;

ç) plotëson saktë dhe në kohë regjistrat elektronikë për mallrat që hyjnë dhe dalin në objektet që administron;

d) kryen inventarin fizik çdo 6 (gjashtë) muaj dhe i raporton të dhënat në regjistrin elektronik doganës mbikëqyrëse dhe administratorit të zonës;

dh) ruan kopje origjinale të të gjitha transaksioneve, kartave teknologjike dhe analizave të kryera;

e) bashkëpunon me administratorin e zonës dhe doganën për çdo çështje që ka lidhje me mbikëqyrjen e aktivitetit brenda zonës;

ë) kujdeset për respektimin e rregullave për ambientin dhe sigurinë.

2. Operatori ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) është përgjegjës për mallrat, sipas përcaktimeve të nenit 215, të Kodit;

b) mirëmban e siguron kushtet teknike të objekteve që ka në administrim në mënyrë që mallrat nën regjim të mos kenë asnjë dëmtim;

c) është përgjegjës për regjistrimet e sakta dhe në kohë reale të transaksioneve që kryen me mallrat në objektet dhe veprimtaritë që kryen në zonë;

ç) është përgjegjës për inventarin e mallrave nën regjim dhe çdo mangësi apo mospërputhje e ngarkon me përgjegjësi para ligjit;

d) Mban përgjegjësi dhe ka në ngarkim çdo borxh doganor që mund të lindë gjatë aktivitetit në zonë.

Neni 648–11

Ndërtesat, objektet në zonë

(Neni 217 i Kodit)

1. Çdo ndërtesë, depozitë, silos, magazinë, shesh, linjë teknologjike, impiant, për efekte doganore, do të identifikohen me termin "objekt".

2. Para ndërtimit të ndërtesës në një zonë të lirë merret miratimi paraprak nga Drejtoria e

Përgjithshme e Doganave. Objektet në zonë miratohen nga drejtori i Përgjithshëm i Doganave me kërkesën e administratorit të zonës.

3. Administratori i zonës ka detyrimin të përshkruajë në mënyrë të detajuar objektin, proceset që do të kryhen, produktet që do të hyjnë në zonë, mënyrën e identifikimit dhe të matjes së produkteve.

4. Çdo objekt në zonë kodifikohet sipas metodikës që administratori i zonës ka zgjedhur për efekte regjistrash e inventari.

5. Me miratimin e objektit, administratori i zonës merr masat për regjistrimin e tij në sistem. Për çdo kategori objektesh të miratuara, administratori i zonës harton rregulloren e funksionimit të objektit dhe e dërgon për njohje pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

6. Të gjitha objektet duhet të jenë tërësisht funksionale. Në rast se konstatohen mangësi teknike që cenojnë ruajtjen e përshtatshme të mallrave nën regjim, administratori i zonës bën menjëherë pezullimin e aktivitetit në objekt dhe njofton zyrën doganore mbikëqyrëse për defektin dhe pasojat që ka sjellë. Operatori, i cili kryen aktivitet në objekt, mund të transferojë mallrat në një objekt tjetër brenda zonës së lirë, për të mundësuar riparimin e defekteve. Pasi objektet janë rikthyer në kushte teknike për veprimtarinë e autorizuar, administratori i zonës së lirë njofton zyrën doganore mbikëqyrëse për gatishmërinë e objektit.

Neni 648–12
Pezullimi i autorizimit për veprimtari në zonë
(Nenet 28 dhe 217 të Kodit)

1. Autorizimi për veprimtari në zonë pezullohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kur:

a) nga autoritetet doganore konstatohen mospërputhje me përcaktimet e nenit 648–10, të këtij vendimi;

b) autoriteti doganor ka arsye të mjaftueshme të besojë që një veprim, i cili mund të shkaktojë procedim penal lidhur me shkelje të legjislacionit doganor, të akcizës apo atë tatimor, është kryer nga operatori, anëtarët e bordit apo të këshillit drejtues/këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, në rast se operatori ekonomik aplikues është një shoqëri aksionare ose personi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore.

2. Para marrjes së vendimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ia komunikon konstatimet operatorit për veprimtari në zonë. Operatori ka të drejtë të korrigjojë situatën dhe/ose të shprehë qëndrimin e tij brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e komunikimit.

Në rast të kundërt Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton operatorin për pezullimin për një periudhë kohore prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke i mundësuar atij marrjen e masave të kërkuara për të rregulluar situatën.

3. Në rastet e referuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pezullon autorizimin deri në fund të procedimit penal dhe njofton operatorin për këtë qëllim.

4. Kur operatori nuk është në gjendje të rregullojë situatën brenda 30 (tridhjetë) ditëve, por mund të japë prova që kushtet mund të përmbushen nëse shtyhet periudha e pezullimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pezullon autorizimin për një periudhë tjetër prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike. Për këtë qëllim, njoftohet operatori.

5. Gjatë periudhës së pezullimit të autorizimit për veprimtari në zonë, objektet mbyllen me dry/plumbosje nga administratori dhe zyra doganore mbikëqyrëse. Vetëm nën mbikëqyrjen e zyrës doganore mbikëqyrëse këto ambiente mund të hapen dhe operatori mund të kryejë vetëm veprime që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e pajisjeve apo të mallrave, si dhe t'u japë destinacion tjetër mallrave që janë në prag të skadimit.

Neni 648–13
Pezullimi i aktivitetit për objektet

Të gjitha objektet, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 648–11, të këtij vendimi, duhet të jenë tërësisht funksionale. Në rast se nga administratori i zonës konstatohen mangësi teknike që cenojnë ruajtjen e përshtatshme të mallrave nën regjim, ky i fundit bën menjëherë pezullimin e aktivitetit në objekt dhe njofton doganën për defektin dhe pasojat që ka sjellë.

Në rastet kur mangësitë teknike konstatohen nga autoriteti doganor, menjëherë bëhet njoftimi i administratorit të zonës për pezullimin e objektit.

Operatori, i cili kryen aktivitet në objekt, me konfirmim nga zyra doganore, mund të transferojë mallrat në një objekt tjetër për të mundësuar riparimin e defekteve.

Neni 648–14
Heqja e pezullimit të autorizimit për veprimtari në zonë
(Nenet 28 dhe 217 të Kodit)

1. Kur operatori vlerësohet se ka marrë masat e nevojshme për të plotësuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave heq pezullimin dhe informon operatorin dhe administratorin e zonës. Pezullimi mund të hiqet përpara përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në nenin 648–12, të këtij vendimi.

2. Nëse operatori në zonë dështon të marrë masat e nevojshme brenda periudhës kohore të pezullimit të parashikuar në nenin 648–12, të këtij vendimi, atëherë zbatohet neni 648-16, i këtij vendimi.

Neni 648–15
Heqja e pezullimit të autorizimit për objekt në zonë
(Nenet 28 dhe 217 të Kodit)

1. Pasi objektet janë kthyer në kushte teknike për veprimtarinë e autorizuar, administratori i zonës njofton doganën për gatishmërinë e objektit dhe, nëse nuk ka një refuzim nga kjo e fundit për 24 (njëzet e katër) orë, bën aktivizimin e objektit.

2. Nëse operatori në zonë dështon të marrë masat e nevojshme brenda periudhës kohore të pezullimit të parashikuar në nenin 648–12, të këtij vendimi, atëherë zbatohet *mutatis mutandis*, neni 648–16, i këtij vendimi.

Neni 648–16
Shfuqizimi i autorizimit për veprimtari në zonë
(Neni 217 i Kodit)

Me propozimin e zyrës doganore mbikëqyrëse të zonës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave shfuqizon autorizimin për veprimtari në zonë, në rastet, si më poshtë vijon:

a) kur operatori dështon të rregullojë situatën e referuar në nenin 648–12, të këtij vendimi;

b) kur janë identifikuar në mënyrë të përsëritur raste kundërvajtjeje në plotësimin e kushteve për hyrje-daljen e mallrave e regjistrimin e tyre;

c) kur janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura lidhur me legjislacionin doganor, akcizën apo atë tatimor nga operatori ose personat e tjerë të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 648–12, të këtij vendimi, dhe kur ka shteruar e drejta e ankimimit;

ç) kur operatori falimenton sipas vendimit gjyqësor;

d) me kërkesë të operatorit.

Neni 648–17
Anulimi, shfuqizimi i autorizimit për objekte dhe veprimtari në zonë
(Neni 217 i Kodit)

1. Me propozimin e zyrës doganore mbikëqyrëse të zonës së lirë doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave anulon një autorizim për veprimtari në zonë të lirë doganore, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) autorizimi është dhënë bazuar në informacion të rremë, të pasaktë ose të falsifikuar;

b) personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i rremë, i pasaktë ose i falsifikuar.

2. Anulimi i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit fillestar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin doganor, në vendim specifikohet ndryshe.

3. Në rast shfuqizimi ose anulimi të autorizimit për veprimtari në zonë, mallrave në regjimin e zonës u jepet një regjim doganor sipas përcaktimeve të nenit 221 të Kodit.

Neni 648–18
Rakordime dhe kontrolle
(Neni 218, 219, 220, 221 dhe 222, të Kodit)

1. Pas miratimit të zonës së lirë doganore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave miraton:

a) rregulloren për funksionimin e zonës së lirë doganore. Rregullorja përmban rregullat dhe kushtet për organizimin e zonës, sigurinë e ndërtesave dhe objekteve, sigurinë dhe kushtet e punës, lejet dhe dokumentet e hyrjes/daljes së mallrave/personave në zonë etj.;

b) regjistrat e paraqitur nga administratori dhe aplikuesi për objektet dhe veprimtarinë në zonë.

2. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, administratori dhe operatori janë të detyruar të regjistrojnë e të dokumentojnë të gjitha hyrjet/daljet e mallrave në zonën e lirë doganore, si dhe të paraqesin pranë autoriteteve doganore të zyrës mbikëqyrëse për çdo rast, sipas legjislacionit në fuqi, deklarimet, të shoqëruara me dokumentet përkatëse.

3. Brenda datës 5 (pesë) dhjetor të çdo viti, administratori dhe operatori, dorëzojnë pranë autoriteteve doganore të zyrës mbikëqyrëse raport për gjendjen e mallrave.

4. Të gjitha veprimet për hyrjen/daljen e mjeteve e të mallrave në dhe nga zona janë objekt i njoftimit dhe lejes përkatëse të autoriteteve doganore të zyrës mbikëqyrëse. Këto veprime mund të kryhen vetëm gjatë orarit të përcaktuar nga autoritetet doganore.

Seksioni 4
Krijimi apo shfuqizimi i zonës së lirë doganore

Neni 648–19
Propozimi për krijimin e zonës së lirë doganore
(Neni 216 i Kodit)

Ministria përgjegjëse për financat i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për krijimin e zonës së lirë doganore, në përputhje me nenin 216, të Kodit.

Neni 648–20
Dokumentet tip që i bashkëlidhen propozimit për krijimin dhe shtrirjen territoriale të zonës së lirë doganore
(Neni 216 i Kodit)

1. Propozimit për krijimin dhe shtrirjen territoriale të zonës së lirë doganore i bashkëlidhet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) kërkesa e subjektit apo e subjekteve (aplikuese), shoqëruar me informacion lidhur me aktivitetin e tyre;

b) planvendosja e territorit që propozohet për krijimin e zonës së lirë doganore, e hartuar nga ekspertë të licencuar, ku të jenë përcaktuar pikat e hyrjes e të daljes;

c) në rastin kur zona e lirë doganore do të krijohet në pasurinë në pronësi të aplikuesit kërkues, duhet të dorëzohet përshkrimi i pronës private, vendndodhja e saj, dokumenti i pronësisë, statusi juridik aktual i pasurisë i lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, shoqëruar me hartën treguese të pasurisë;

ç) në rastin kur zona e lirë doganore do të krijohet në pasuri, jo në pronësi të aplikuesit kërkues, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në shkronjën "c", duhet të dorëzohet edhe aktmarrëveshja paraprake, e lidhur ndërmjet aplikuesit kërkues dhe pronarit të pasurisë;

d) mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit për krijimin dhe shtrirjen territoriale të zonës së lirë doganore.

2. Pas miratimit të zonës së lirë doganore nga Këshilli i Ministrave, aplikuesit kërkues shprehin vullnetin me akt noterial për administratorin që gëzon besimin e autorizimin e pronarëve apo poseduesve ligjorë të pronave brenda perimetrit të miratuar të Zonës, me qëllim që ky i fundit të aplikojë për administrimin e një zone të lirë doganore, sipas aneksit 14, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në këtë aneks.

Neni 648–21
Shfuqizimi i zonës së lirë doganore

1. Me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, Këshilli i Ministrave shfuqizon vendimin për autorizimin e zonës së lirë doganore në rastet e mëposhtme:

a) kur aplikuesi kërkues apo administratori dështon të rregullojë situatën lidhur me detyrimet e përcaktuara në këtë vendim;

b) kur janë verifikuar në mënyrë të përsëritur raste kundërvajtjeje në plotësimin e kushteve për hyrje-daljen e mallrave dhe regjistrimin e tyre;

c) kur janë kryer shkelje të rënda dhe të përsëritura lidhur me legjislacionin doganor, të akcizës apo atë tatimor;

ç) kur zona e lirë doganore nuk ka filluar aktivitet apo kur ka pushuar së kryeri aktivitet për të paktën 2 (dy) vjet;

d) me kërkesë të aplikuesit kërkues.

2. Në rast shfuqizimi, mallrave në regjimin e zonës së lirë doganore u jepet një regjim doganor sipas përcaktimeve të nenit 221, të Kodit.”.

2. Në shtojcën A, anekset 14 e 15 zëvendësohen përkatësisht me anekset 14, “Aplikim për administrimin e zonës së lirë doganore” dhe 15, “Autorizim për administrimin e një zone të lirë doganore”, si dhe shtohen anekset 16, “Aplikimi për veprimtari në zonë të lirë doganore”; 17, “Autorizim për veprimtari në zonë të lirë doganore”; 18, “Aplikimi për objekte në zonë të lirë doganore” dhe 19, “Autorizim për objekte në zonë të lirë doganore” që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 14
APLIKIM PËR ADMINISTRIMIN E NJË ZONE TË LIRË DOGANORE

1. Aplikuesi/t, numri i identifikimit, informacionet e kontaktit:
……..……
…….
……..……
…….

2. Vendndodhja, objektet, harta e zonës së lirë doganore:
……..……
…….
……..……
…….

3. Detyrimet që i ngarkohen administratorit (person juridik i vendosur në RSH) të zonës së lirë doganore:
……..……
…….
……..……
…….

4. Përgjegjësitë që i ngarkohen administratorit të zonës së lirë doganore:
……..……
…….
……..……
…….
…….

5. Akt noterial ndërmjet kandidatit për administrator dhe aplikuesit/ve, të cilëve sipas kërkesës u është miratuar zona e lirë doganore:
……..……
…….
……..……

6. Dokumentet dhe materialet shoqëruese:
…….
…….
…….

Data: …….

Emri, mbiemri, firma, vula: ……
(administratorët)

SHËNIME SHPJEGUESE PËR ANEKSIN 14

1. Shkruani emrin, adresën e plotë të aplikuesit dhe numrin e identifikimit.
2. Përcaktoni vendndodhjen, objektet, hartën e zonës së lirë doganore të miratuar nga Këshilli i Ministrave që synohet të administrohet.
3. Shkruani detyrimet që i ngarkohen administratorit, që së paku janë ato të përcaktuara në këtë vendim.
4. Shkruani përgjegjësitë që i ngarkohen administratorit, që së paku janë ato të përcaktuara në këtë vendim.
5. Përcaktoni në mënyrë të qartë numrin dhe datën e aktit noterial që do t'i bashkëlidhet aplikimit.
6. Vendosni në mënyrë të qartë listën e të gjithë dokumenteve, të cilat shoqërojnë aplikimin.

Të dhënat jokonfidenciale të aksesueshme për publikun e gjerë:

Publikut të gjerë do t'i jepet akses në të dhënat e mëposhtme (duke iu referuar formularit të aplikimit):

- numri i autorizimit të dhënë;
- emri i shoqërisë së autorizuar për administrimin e zonës së lirë doganore.

ANEKSI 15
AUTORIZIM PËR ADMINISTRIMIN E NJË ZONE TË LIRË DOGANORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVEDHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

1. Mbajtësi: **Numri identifikues:**	**AUTORIZIMIN PËR ADMINISTRIMIN E NJË ZONE TË LIRË DOGANORE** **Nr.:** _____
2. Aplikimi: *nr.*_____, *datë* _____	*Dega e Doganës* _____ **3. Zyra mbikëqyrëse:**
4. Ambientet e zonës së lirë doganore:	
5. Orari i veprimeve:	**6. Data e hyrjes në fuqi:**
7. Detyrimet/përgjegjësi e zbatueshme:	**8. Porta e hyrjes:**
	9. Porta e daljes:
10. Dispozitat ligjore të detyrueshme për zbatim:	
11. Shënime:	
12. Autoriteti që miraton: DPD **Vendi:** **Data:** ___/___/___	**13. Shtojca:**

ANEKSI 16
APLIKIM PËR VEPRIMTARI NË ZONË TË LIRË DOGANORE

1. Aplikuesi, numri i identifikimit, informacionet e kontaktit:
……..……
…….
……..……
…….
……..……
…….

2. Kodi i veprimtarisë:
……..……
…….
……..……
…….
……..……
…….

3. Përshkrimi i aktivitetit:
……..……
…….
……..……
…….

4. Natyra e objektit që do të ushtrojë aktivitetin:

……..……
…….
……..……
…….
……..……
…….

5. Përcaktimi i nevojës ekonomike për këtë aktivitet:
……..……
…….

6. Të tjera sqarime nga aplikuesi:
……..……
…….

Data: …….

Emri, mbiemri, firma, vula: …….

SHËNIME SHPJEGUESE PËR ANEKSIN 16

1. Shkruani emrin, adresën e plotë të aplikuesit dhe numrin e identifikimit. Aplikuesi është personi, të cilit mundet t'i lëshohet autorizimi. Shkruani informacionin e duhur të kontaktit (personin e kontaktit, adresën e kontaktit, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e *e-mail*-it).

2. Përcaktoni një kod të aktivitetit që synohet të ushtrohet në zonë.

3. Shkruani aktivitetin, i cili do të kryhet në zonë. Nevojitet të përshkruhet në mënyrë të detajuar aktiviteti, proceset që do të kryhen, mallrat që do të hyjnë, produktet e përpunuara, humbjet teknike dhe firot ligjore.

4. Shkruani natyrën e objektit që do të përdoret në ushtrimin e aktivitetit.

5. Përcaktoni në mënyrë të qartë nevojat ekonomike për këtë aktivitet.

6. Të tjera sqarime shtesë nga aplikuesi.

Të dhënat jokonfidenciale të aksesueshme për publikun e gjerë:

Publikut të gjerë do t'i jepet akses në të dhënat e mëposhtme (duke iu referuar formularit të aplikimit):

- numri i autorizimit të dhënë;
- kodi i zyrës doganore mbikëqyrëse.

ANEKSI 17
AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI NË ZONË TË LIRË DOGANORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1.Mbajtësi: **Numri identifikues:**	**AUTORIZIM PËR VEPRIMTARI NË ZONË TË LIRË DOGANORE** **Nr:** _____
2. Aplikimi: *nr.*_____, *datë* _____	**3. Zyra mbikëqyrëse:** *Dega e Doganës* _____
4. Ambientet e zonës së lirë doganore:	
5. Orari i veprimeve:	**6. Data e hyrjes në fuqi:**
7. Operacione të zbatueshëm: **në hyrje:** **në dalje:**	**8. Porta e hyrjes:** **9. Porta e daljes:**
10. Mallrat që mund të pranohen:	**11. Shkalla humbje/firo:**
12. Mallra të tjerë:	
13. Dispozitat ligjore të detyrueshme për zbatim:	
14. Shënime:	
16. Autoriteti që miraton: DPD **Vendi:** **Data:** ___/___/___	**15. Shtojca:**

ANEKSI 18
APLIKIM PËR OBJEKTE NË ZONË TË LIRË DOGANORE

1. Aplikuesi, numri i identifikimit, informacionet e kontaktit:
……..……
…….

2. Kodi i objektit:
……..……
…….
……..……
…….
……..……
…….

3. Përshkrimi i objektit:
……..……
…….
……..……
…….

4. Natyra e mallrave që do të magazinohen/përpunohen:
……..……
…….

5. Përshkrimi i nevojës ekonomike për këtë objekt:
……..……
…….
……..……
…….

6. Të tjera sqarime nga aplikuesi:
……..……
…….
……..……
…….
……..……
…….

Data: …….

Emri, mbiemri, firma, vula: …….

SHËNIME SHPJEGUESE PËR ANEKSIN 18

1. Shkruani emrin, adresën e plotë të aplikuesit dhe numrin e identifikimit. Aplikuesi është personi, të cilit mundet t'i lëshohet autorizimi. Shkruani informacionin e duhur të kontaktit (personin e kontaktit, adresën e kontaktit, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e-mail-it).

2. Përcaktoni kodin e objektit, instalimet që synohen të përdoren në zonën e lirë doganore dhe parashikimin se si godina/ambienti/instalimet janë projektuar për të funksionuar.

3. Shkruani tipin e objektit, ku do të magazinohen apo përpunohen mallrat.

4. Shkruani natyrën e mallrave që do të magazinohen/përpunohen, përshkrimin tregtar dhe kodin tarifor.

5. Shkruani nevojën ekonomike për objektin.

6. Të tjera sqarime shtesë nga aplikuesi.

Të dhënat jokonfidenciale të aksesueshme për publikun e gjerë:

Publikut të gjerë do t'i jepet akses në të dhënat e mëposhtme (duke iu referuar formularit të aplikimit):

- numri i autorizimit të dhënë;
- kodi i zyrës doganore mbikëqyrëse.

ANEKSI 19
AUTORIZIM PËR OBJEKTE NË ZONË TË LIRË DOGANORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

1.Mbajtësi: **Numri identifikues:**	**AUTORIZIM PËR OBJEKTE NË ZONË TË LIRË DOGANORE** **Nr.:** _____
2. Aplikimi: *nr.*_____, *datë* _____	**3. Zyra mbikëqyrëse:** *Dega e Doganës* _____
4. Ambientet e zonës së lirë doganore:	
5. Orari i veprimeve:	**6. Data e hyrjes në fuqi:**
7. Operacione të zbatueshëm: **në hyrje:** **në dalje:**	**8. Porta e hyrjes:** **9. Porta e daljes:**
10. Mallrat që mund të pranohen:	**11. Shkalla humbje / firo:**
12. Shënime:	
14. Autoriteti që miraton: DPD **Vendi:** **Data:** ___/___/___	**13. Shtojca**:

VENDIM
Nr. 639, datë 2.10.2019

PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", me propozimin të Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) të sporteleve të shërbimit ndaj qytetarit të:

a) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT);

b) Shërbimit Shtetëror të Gjendjes Civile;

c) Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA);

ç) Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH);

d) Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH);

dh) Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

2. Në rastet përjashtimore dhe me marrëveshje ndërmjet palëve, shërbimet, të cilat, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të ofrohen nga sportelet e ADISA-s, do të vazhdojnë të ofrohen drejtpërdrejt nga vetë institucioni.

3. Përjashtohen nga zbatimi i këtij vendimi, duke u ofruar drejtpërdrejt nga strukturat rajonale / vendore të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, shërbimet, si më poshtë vijon:

a) informimi për punëkërkuesit, punëdhënësit dhe për çdo person të interesuar si pjesë e procesit të ndërmjetësimit;

b) ndërmjetësimi për punësim;

c) këshillimi dhe orientimi për karrierë, punësim e profesion.

4. Shërbimet e gjendjes civile do të ofrohen njëkohësisht nga ADISA dhe nga Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për gjendjen civile.

5. Punonjësit aktualë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), të cilët ushtrojnë funksionin e sportelit, kalojnë si punonjës të Agjencisë së Ofrimit të Shërbime Publike të Integruara (ADISA).

6. Aplikimi për marrjen e shërbimeve të institucioneve të parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga ADISA, do të kryhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.13/2016, datë 18.2.2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", si dhe sipas parashikimeve të legjislacionit sektorial që rregullon dhënien e këtyre shërbimeve publike. Për një rregullim më të detajuar, ADISA dhe institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, mund të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi, në të cilën detajohen format, procedurat e mënyrat e bashkëpunimit.

7. Për ato njësi vendore në të cilat ADISA nuk ka sportele shërbimi, deri në ngritjen e tyre, këto shërbime do të ofrohen nga vetë institucionet e administratës shtetërore të përcaktuara, sipas pikës 1, të këtij vendimi. Me përjashtim të sporteleve që ofrojnë shërbimet e parashikuara sipas pikave 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi, me ngritjen e sporteleve të ADISA-s, sportelet e institucioneve të administratës shtetërore në ato njësi vendore, përfshirë edhe zyrat vendore të ASHK-së, mbyllen.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 7.9.2016, "Për kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)", i ndryshuar; nr. 715, datë 5.12.2018, "Për kalimin e sporteleve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në administrimin e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)", dhe nr. 757, datë 26.10.2016, "Për kalimin e sporteleve pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në administrimin e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara", i ndryshuar, shfuqizohen.

9. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurimeve

Shoqërore dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 640, datë 2.10.2019

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT DHE TË REZULTATEVE NË PUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 34, të ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe të rezultateve në punë, në kuptim të pikës 4, të nenit 34, të ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë", është Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

2. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 641, datë 2.10.2019

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE FUSHËN E VEPRIMIT TË POLICIMIT VULLNETAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 76, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE FUSHA E VEPRIMIT TË SHËRBIMIT TË POLICIMIT VULLNETAR

1. Shërbimi i policimit vullnetar funksionon në mbështetje të strukturave vendore të Policisë së Shtetit dhe bashkëpunon me këto të fundit me qëllim:

a) sigurimin dhe garantimin e rendit publik në aktivitetet me karakter masiv, si tubime, koncerte, festivale, aktivitete sportive dhe organizime fetare;

b) dhënien e ndihmës për menaxhimin e trafikut rrugor në qendrat urbane dhe rurale;

c) dhënien e ndihmës për rritjen e sigurisë publike pranë institucioneve arsimore;

ç) kontrollin e territorit, mbështetjen e patrullimit policor për parandalimin e krimit dhe ndërhyrjen ndaj shkeljeve të ligjit;

d) përballimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave civile, fatkeqësive natyrore, si dhe operacioneve të kërkim-shpëtimit me karakter masiv.

2. Polici vullnetar e kryen veprimtarinë e tij nën mbikëqyrjen e punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili caktohet nga drejtuesi i strukturës vendore.

3. Kryerja e shërbimit të policimit vullnetar është i papajtueshëm me funksionet e gjyqtarit, prokurorit, përmbaruesit gjyqësor, drejtuesit në strukturat politike, punonjësit në institucionet e sigurisë kombëtare apo publike, të shërbimit të provës, të policisë së burgjeve dhe të Gardës së Republikës.

II. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN E POLICIMIT VULLNETAR

1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

c) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit apo i larguar nga administrata publike;

ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;

d) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

dh) të jetë i moshës nga 18 deri në 65 vjeç, në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën.

2. Kriteret e veçanta të pranimit të shtetasit në shërbimin e policimit vullnetar janë, si më poshtë vijon:

a) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm me vlerësim pozitiv, si dhe të jetë i certifikuar nga Akademia e Sigurisë;

b) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë.

III. TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E POLICIT VULLNETAR

1. Polici vullnetar ka të drejtë:

a) të njihet paraprakisht me të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë e shërbimit të policimit vullnetar, si dhe me sanksionet në rast të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe nga kontrata individuale e vullnetarizmit;

b) të rimbursohet për shpenzimet e kryera gjatë orarit të shërbimit apo jashtë qendrës së banimit, në ndihmë të strukturave policore;

c) të pajiset me veshje, shenja dalluese dhe pajisje të tjera ndihmëse, të përcaktuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në përputhje me natyrën e aktiviteteve të vullnetarizmit dhe shërbimeve që do të kryejë;

ç) të kërkojë në mënyrë individuale vlerësim ose vërtetim pjesëmarrjeje për kontributin e punës vullnetare të dhënë prej tij nga struktura vendore e policisë;

d) të kryejë trajnime falas në Akademinë e Sigurisë, sipas programeve të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

2. Polici vullnetar gjatë shërbimit dhe/ose jashtë tij ka përgjegjësi:

a) të ndjekë programin e trajnimit të detyrueshëm;

b) të marrë pjesë në trajnime që organizon Policia e Shtetit, për të përmirësuar cilësinë e punës e të shërbimit;

c) të kryejë aktivitetin e vullnetarizmit i paarmatosur, në përputhje me rregullat, udhëzimet dhe kërkesat e etikës së punonjësve të Policisë së Shtetit;

ç) të ruajë sekretin profesional, si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, me të cilat njihet gjatë angazhimit, si polic vullnetar;

d) të zbatojë detyrat dhe udhëzimet e dhëna nga mbikëqyrësi në nivel vendor i Policisë së Shtetit, përveç rasteve kur:

i. janë në kundërshtim me ligjin;

ii. paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e vullnetarit, si dhe atë të njerëzve të tjerë;

iii. konsiderohen moralisht të papranueshme nga ana e vullnetarit;

iv. vijnë në kundërshtim me kontratën e vullnetarizmit;

dh) të njoftojë përfaqësuesin apo mbikëqyrësin e Policisë së Shtetit, në lidhje me pasojat, kur ndodhet përpara zbatimit të urdhrave që mund t'i shkaktojnë dëme të shëndetit ose jetës së tij.

3. Gjatë shërbimit, polici vullnetar mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga veprimet e tij të kryera në kundërshtim me ligjin.

4. Polici vullnetar kryen shërbime publike në mbështetje të punonjësve të Policisë së Shtetit.

IV. PËRGJEGJËSITË E PËRFITUESIT TË SHËRBIMIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është përgjegjëse për përzgjedhjen, trajnimin, organizimin, drejtimin dhe trajtimin e policit vullnetar, duke u siguruar që:

a) të trajnojë paraprakisht kandidatët që do të certifikohen si të aftë për të kryer detyra në ndihmë të Policisë së Shtetit;

b) të sigurojë kushte normale pune për policin vullnetar, gjatë kryerjes së detyrave në bazë të kontratës së shërbimit vullnetar;

c) të ruajë dhe të sigurojë konfidencialitetin e të dhënave dhe mbrojtjen e privatësisë së policit vullnetar;

ç) të rimbursojë shpenzimet e kryera nga polici vullnetar gjatë punës vullnetare, sipas akteve nënligjore në fuqi për trajtimin me dieta, njëlloj si punonjësit e policisë;

d) të lëshojë vërtetim me shkrim për kohën e punës që ai ka shërbyer si polic vullnetar;

dh) të ofrojë bazën e nevojshme materiale për kryerjen e aktivitetit të vullnetarizmit;

e) të sigurojë plotësimin e kushteve të nevojshme për respektimin e të drejtave të policit vullnetar;

ë) të trajtojë policin vullnetar sipas përcaktimeve të bëra në nenin 106, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar;

f) të pajisë policin vullnetar me dokument identifikimi, lidhur me statusin që ai gëzon, sipas modelit të përcaktuar me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Çdo vit, në bazë të nevojave dhe propozimeve të drejtorive vendore të policisë,

drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton numrin e policëve vullnetarë.

V. KONTRATA E VULLNETARIZMIT

1. Kontrata e vullnetarizmit lidhet në formë të shkruar ndërmjet policit vullnetar dhe drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë.

2. Kontrata e vullnetarizmit përcakton të drejtat, detyrat, kushtet dhe kriteret e nevojshme për kryerjen e shërbimit të policimit vullnetar.

3. Forma dhe përmbajtja e kontratës tip, efektet, kohëzgjatja, përfundimi apo zgjidhja e saj, si dhe procedurat e ankimit, të pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së ankimit përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 642, datë 2.10.2019

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "MTSC" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE "ISH-NDËRMARRJE METALIKE 'TIRANA'" (REPARTI I ORËVE), PRONA NR. 19, ME NUMËR PASURIE 7/649, ZONA KADASTRALE 8220, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË NDËRMARRJES INDUSTRIALE NR. 1, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "MTSC" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore "Ish-ndërmarrje metalike 'Tirana'" (Reparti i orëve), prona nr. 19, me numër pasurie 7/649, me sipërfaqe të përgjithshme 4021.50 m², nga të cilat sipërfaqe ndërtimore 1624.44 m², dhe sipërfaqe funksionale 2397.06 m2, zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN - RILEVIMI

PERGATITI	IDENTIFIKIMI I PASURISE
STUDIO PROJEKTIMI IRGEN SGT GROUP LIÇENSA NR: 6806 KAT 8(a,b,d,e) DATE: 28 - 02 - 2017 DATA E PERGATITJES: 18-06-2019	ZONA KADASTRALE NUMER:8220 NUMERI I PASURISE:7/649 VOL. 53 **FQ.14 ;** INDEKSI I HARTES : **TR; P-7** SHKALLA: **1 :1000** ADRESA E PASURISE:TIRANE Q/E :TIRANE RRUGA:"NDRE MJEDA" PALL/GOD: _____SHKALLA: _____ KATI: APARATAMENTI: PRONAR: **NDERMARJA INDUSTRIALE NR 1 .**

Sip TRUALL =4021.50m².
Sip NDERTESE =1624.44m².
Sip FUNKSIONALE=2397.06m².



NDERMARJA INDUSTRIALE NR 1

DREJTOR

EDLIRA PERFUNDI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË

1811769

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8220

Numri i Pasurisë 7/649 Volumi 53 Faqe 14

Adresa e Pasurisë TIRANE Rruga NDRE MJEDA

Lloji i Pasurisë TRUALL

Sipërfaqja Totale 4021.50 m2

Nga kjo : Sa Truall 4,021.50 Nga kjo : Sa Ndërtesa 1,624.44

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
REPUBLIKA E SHQIPERISE			1/1	TIRANE

- është pronar i pasurisë me numër 7/649
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (i) më datë 5/5/2019 **me** 49485

Data e lëshimit të çertifikatës 3/6/2019

Lëshuesi i çertifikatës REGJISTRUESI

Miratuar nga V. K.M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 53, Fq. 14

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 8220 NR.i PASURISE : 7/649

Indeksi i Hartes: TR-P-7

Adresa e Pasurisë: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE

Rr/L NDRE MJEDA P/G ____ SH ___K ___ Ap ___

--> Vijon nga: Vol _____, Fq _____

Vijon në: Vol _____, Fq _____ deri në: Vol _____, Fq _____ -->

PERFUNDIMTARE (data): _____

Përshkrim i veçantë:

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO , Ref :PL RREGULLUES

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë
1. 4,021.50 m^2 Ref 00016400	1. 4,021.50 m^2 Ref 00016400	1. 306.30 m^2 Ref 00016400
2. 4,021.50 m^2 Ref 00016401	2. 4,021.50 m^2 Ref 00016401	2. 1,624.44 m^2 Ref 00016401
3. ____ m^2 Ref ____	3. ____ m^2 Ref ____	3. ____ m^2 Ref ____
4. ____ m^2 Ref ____	4. ____ m^2 Ref ____	4. ____ m^2 Ref ____

Per pjesen e përbashkët

PALLAT

Kuota e pjesmarrjes: ____ %

Nr i Pasurise (pallat):

Vol. ____ Faqe ____

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00016401	03/06/2019	REPUBLIKA E SHQIPERISE		I	TIRANË		03/06/2019	urdh min nr.120 dt.20.04.2019	

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqesues i familjes; B - bashkëpronar (%)

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
00016401	03/06/2019	L1	NE ADMINISTRIM TE NDERMARRJES INDUSTRIALE NR.1 TIRANE		URDHER MIN 120 DT. 20.04.2019	

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordan Misja, Tirane

TIRANË, me 3 / 6 /2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vol 53, Faqe 14, Zona Kadastrale 8220, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË	A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
REGJISTRUESI	ZONA KADASTRALE 8220
	NR. I PASURISE: 7/649 VOL 53 FQ 14
	INDEKSI I HARTES: TR-P-7 SHKALLA: 1:1000
	ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F TIRANE
	Rr/L.: NDRE MJEDA P/G SH K ___Ap
	B. KUFIZIMET C. PRONARI
	V. 7/336 REPUBLIKA E SHQIPERISE
	L. 7/257
	U. 7/606, 7/600, 7/602
	P. 7/624
Vula/Firma	D. Data: 03/06/2019 Ora: 12:03:09PM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ rep.
Nr. _____ kol.

DRAFTKONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata
Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____, të muajit _____ të vitit 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit _____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. _____ nga z/znj. _____ me detyrë _____, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes __.__._____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet "Qiradhënësi",

dhe

Shoqëria "MTSC" sh.p.k., me seli qendrore në Tiranë, me adresë, rruga "Niko Pushkin", Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: L51817008H, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë z. , i datëlindjes _____, lindur në _____,dhe banues në _____, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimi personal me nr. _____që më poshtë do të quhet "QIRAMARRËSI".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr.____, datë __.__.____, të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Qiradhënës dhe shoqërisë "MTSC" sh.p.k., si Qiramarrës, për pronën shtetërore "*ish-Ndërmarrje Metalike "Tirana" (Reparti i Orëve), prona me nr. 19, me numër pasurie 7/649, me sipërfaqe të përgjithshme 4021.50 m², nga të cilat sipërfaqe ndërtimore 1624.44 m², dhe sipërfaqe funksionale 2397.06 m², zona kadastrale 8220,* në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore *"ish-Ndërmarrje Metalike "Tirana" (Reparti i Orëve), prona me nr. 19, me numër pasurie 7/649, me sipërfaqe të përgjithshme 4021.50 m², nga të cilat sipërfaqe ndërtimore 1624.44 m², dhe sipërfaqe funksionale 2397.06 m², zona kadastrale 8220, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë,* sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP-së Tiranë.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për rikonstruksionin total të sipërfaqes ndërtimore (godinës), duke e kthyer me parametrat teknike të një televizioni bashkëkohor, dhe ambiente pune të përshtatshme dhe cilësore. Në to do të instalohen makineri të teknologjisë moderne të cilat do të mundësojnë rritjen e sasisë dhe cilësisë së programeve në funksion të ngritjes të një qendre mediatike të transmetimeve radio-televizive bashkëkohore.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhe 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", nëpërmjet, Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi", shoqëria "MTSC" sh.p.k., sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim do të investojë për rikonstruksionin total të sipërfaqes ndërtimore (godinës), duke e kthyer me parametrat teknike të një televizioni bashkëkohor, dhe ambiente pune të përshtatshme dhe cilësore. Në to do të instalohen makineri të teknologjisë moderne të cilat do të mundësojnë rritjen e sasisë dhe cilësisë së programeve në funksion të ngritjes të një qendre mediatike të transmetimeve radio-televizive bashkëkohore,

Financimi i projektit parashikohet në vlerën 205 000 000 lekë (pa TVSH) dhe do të përfundojë brenda 60 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse për punimet), e ndarë kjo në:

- investimi që do të kryhet në pasuri të paluajtshme (ngritja e stacionit televiziv) do të jetë në vlerën 152 023 000 lekë, për rikonstruksionin e godinës, impiantet elektrike, kondicionim, sistemime të jashtme etj.;

- investime në pajisje e teknologji televizive do të jetë në vlerën 52 977 000 lekë.

Sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim investimi do të realizohet në tre faza:

Në fazën e parë parashikohet fillimi i punës për rikonstruksionin e godinës. Vlera e investimit në këtë fazë do të jetë rreth 65 000 000 lekë dhe do të përfundojë brenda 18 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit të kontratës dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse.

Kjo fazë investimi do të mbulohet me të ardhurat e vetë shoqërisë "MTSC" SHPK, si dhe me të ardhurat e aksionerit të vetëm të shoqërisë që, ka në llogaritë e tij personale.

Në fazën e dytë përfshihen përsëri punime në godinë, punime shtresash, tavani, suvatime, vendosja e dyerve dhe dritareve, bojatisje, punime të ndryshme, instalime elektrike, instalime sanitare, instalime për ngrohje dhe ventilim, sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit. Gjithashtu në këtë fazë do të mundësohet vendosja e teknologjisë televizive, si rrjetit IT+servera, ndriçime teknologjike, punime të ndryshme. Në këtë fazë synohet që objekti të bëhet funksional për fillimin e transmetimeve në godinën e re.

Vlera e investimit në këtë fazë shkon rreth 105 000 000 lekë, dhe do të përfundojë brenda 18 muajve nga përfundimi i fazës së parë të investimit.

Kjo fazë investimi do të mbulohet me të ardhurat e vetë shoqërisë "MTSC" SHPK, të cilat krijohen nga aktiviteti që ka aktualisht, si dhe kredi bankare.

Në fazën e tretë përfshihen punime në sistemin e jashtëm dhe mobilimin e godinës.

Gjithashtu do të investohet në teknologji televizive, si ndriçime teknologjike, punime të ndryshme etj.

Vlera e investimit në këtë fazë shkon rreth 35 000 000 lekë, dhe do të përfundojë brenda 24 muajve nga përfundimi i fazës së dytë të investimit.

Kjo fazë investimi do të mbulohet me të ardhurat e vetë shoqërisë "MTSC" SHPK, të cilat krijohen nga aktiviteti që shoqëria do të zhvillojë në vijueshmëri.

Shoqëria, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, brenda 60 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse do të investojë në total 205 000 000 lekë (pa TVSH) (dyqind e pesë milionë) lekë. Financimi i projektit dhe investimeve do të bëhet nga fondet e vetë shoqërisë si dhe me kredi bankare.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.8 "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim, merr përsipër që;

- në përfundim të fazës së dytë të investimit, në objektin e kontratës do të punësohen 15 punonjës të rinj,
- dhe në përfundim të fazës së tretë të investimit do të punësohen dhe 18 punonjës të tjerë.

Pra, në total numri i të punësuarve në objektin e kontratës, brenda 60 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse, do të ketë të punësuar minimalisht 33 punonjës të rinj numër i cili do të rritet në varësi të ecurisë së prodhimit.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.9 "Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.10 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që nëpërmjet Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, të paraqesë te "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.13 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.14 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.15 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.16 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.17 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që, të pajiset me Lejet ose Autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.18 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

5.19 Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "qiradhënësit".

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1"Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën _____ lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

d) kur "Qiramarrësi" ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata;

e) kur prona nevojitet për interes publik;

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi;

g) kur "Qiramarrësi" nuk pajiset me autorizim për përpunim aktiv të mallrave, ose rifreskimin e tij, për një periudhë mbi 5 (pesë) muaj.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.7, dhe 5.8 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Ndërmarrja Industriale nr. 1 Tiranë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Qiramarrësi" dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1 Tiranë, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
Përfaqësuar nga

QIRAMARRËSI
Shoqëria "MTSC" sh.p.k.
Përfaqësuar nga

VENDIM
Nr. 643, datë 2.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1056, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK 'PËR SIGURINË E ASHENSORËVE NË PËRDORIM'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në tekstin e rregullit teknik "Për sigurinë e ashensorëve në përdorim", bashkëlidhur vendimit nr. 1056, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 2.4, 2.5 e 11.1 ndryshohen si më poshtë vijon:

"2.4 "Ashensor ekzistues" është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim përpara datës 31 dhjetor 2019.

2.5 "Ashensor i ri" është ashensori i instaluar dhe i vendosur në shërbim, duke filluar që prej datës 1 janar 2020.

...

11.1 Programimi kohor për kryerjen e ekzaminimeve të plota për ashensorët ekzistues.

Ekzaminimi i plotë i ashensorëve ekzistues, të vendosur në shërbim deri më 31 dhjetor 2019, të kryhet jo më vonë se data 31 dhjetor 2020.".

b) Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi "struktura përgjegjëse" zëvendësohet me "Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT)".

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 644, datë 2.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 412, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RISHIKIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 412, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) tabelës bashkëlidhur vendimit i hiqet numri rendor 5 (pesë), me bashkëpronarë z. Batjar Bazaj dhe znj. Luiza Xhaho, me numër pasurie 36/191/ND, zonë kadastrale 8602, me vlerë kompensimi 618 577 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë;

b) në pikat 3 dhe 4, vlerës së përgjithshme të kompensimit të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, i zbritet vlera prej 618 577 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh. Vlerës së shpenzimeve procedurale i shtohet vlera 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, që do të përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

c) ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT PËR "NJË NDRYSHIM NË VKM-në NR. 412, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RISHIKIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS"

Nr.	Nr. rendor në VKM-në nr. 412/20136	Emri	Mbiemri	Z.K.	Nr.Pas	ISHTE		BËHET		Shënime
						Sip. e shpronësuar në VKM-në 412/2016 (m²)	Vlera në VKM-në 412/2016 (lekë)	Sip. Shpron.Arë m²	Vlera	
1	5	Batjar Luiza	Bazaj Xhaho	8602	36/191/ND	31.89	618,577	0	0	Pasuria nr. 36/191/ND, z.k. 8602, në bashkëpronësi të z.Batjar Bazaj dhe Luiza Xhaho, miratuar në VKM-në nr. 412, datë 01.06.2016, me nr. rendor 5, e cila nuk preket nga vija e shpronësimit, në vlerën 618 577 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, hiqet nga shpronësimi, duke bërë edhe korrigjimin në VKM-në e sipërcituar.
Vlera totale e shpronësimit							**618,577**		**0**	

Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit

Nr.	Emër	Mbiemër	Detyra funksionale	Firma
1	Artan	Shkreli	Kryetar	
2	Etleva	Malile	Anëtar	
3	Vjollca	Bazaiti	Anëtar	
4	Arvenola	Naumi	Anëtar	
5	Besmira	Nuredini	Anëtar	

VENDIM
Nr. 645, datë 2.10.2019

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE TË VEPRAVE NDIHMËSE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE TOPOJË, QARKU FIER, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I SHOQËRIVE "SEMAN SUNPOWER" SHPK DHE "SONNE" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe të veprave ndihmëse në njësinë administrative Topojë, qarku Fier, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Seman Sunpower" sh.p.k. dhe "Sonne" sh.p.k., me të dhënat si më poshtë vijon:

a) emri i aplikuesit: bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Seman Sunpower" sh.p.k. dhe "Sonne" sh.p.k.;

b) numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS:

- "SEMAN SUNPOWER", sh.p.k., – K81722018P;
- "SONNE", sh.p.k., – L73015405C;

c) tipi i centralit: eolik;

ç) kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) numri i njësive gjeneruese të burimit gjenerues të energjisë dhe kapaciteti i tyre në mw: 1 (një) turbinë me kapacitet 3 mw;

dh) afati i pritshëm i vënies në punë: koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 24 muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;

e) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: territori në zonën Topojë, qarku Fier;

ë) afati i miratimit të ndërtimit: 48 muaj nga hyrja në fuqi e këtij miratimi;

f) koordinatat e tokës: sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

g) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucione të tjera të autorizuara prej saj kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, me afate 3-mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synimin që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti do të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

gj) bashkimi i përkohshëm i shoqërive "Seman Sunpower" sh.p.k. dhe "Sonne" sh.p.k., ka detyrimin:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. e dorëzimit të sigurimit të kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Seman Sunpower" sh.p.k. dhe "Sonne", sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sasinë e energjisë elektrike, në masën jo më të vogël se 2% të sasisë vjetore të prodhimit ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për energjinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1
KOORDINATAT E TOKËS

Kontratë qiraje toke pasuri shtetërore nr. 1684 rep., nr. 1020 kol., datë 18.6.2015, ndërmjet Bashkisë Fier dhe shoqërisë "Albanian General Electricity" sh.a. Qiradhënësi është pronar i një pasurie të paluajtshme toke pa frutë, me sipërfaqe të përgjithshme 144,000 m^2, e ndodhur në adresën Fier, Topojë, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. 66, datë 11.6.2015, me numër pasurie 55, ndodhur në zonën kadastrale 3358, me kufizimet e pasurisë veri 168, jug 176, lindje 176, perëndim 175.

Akt marrëveshje nr. 2812 prot., datë 28.3.2019 "Për dhënien e të drejtës shoqërisë 'Albanian General Electricity' sh.a, të përdorë sipërfaqen e tokës së dhënë me qira nga Komuna Topojë, me datë 18.6.2015, ose pjesë të saj për implementimin e parqeve eolike (të erës) deri në 3 mw secila (në total 6 mw), në bashkëpunim me shoqëritë: "Sonne" sh.p.k., "Windsbab" sh.p.k. dhe "Seman Sunpower" sh.p.k.

Koordinatat e parkut eolik:

X	Y
4515264.4604	4364035.6680
4515241.3005	4364024.3194
4515162.9989	4364180.0558
4515186.1587	4364191.4669



VENDIM
Nr. 646, datë 2.10.2019

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 65, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Agron Hetoja, drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Robert Lili emërohet drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 647, datë 2.10.2019

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Sajmir Çili lirohet nga detyra si drejtor i Cirkut Kombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 648, datë 2.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 594, DATË 9.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 32/2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

Për pjesën e mbetur të mandatit, sipas pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr.32/2018:

i. znj. Dajna Sorensen emërohet në vend të z. Elton Haxhi, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;

ii. znj. Mira Hoxha emërohet në vend të z. Andris Stastoli, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Emërohet znj. Dajna Sorensen, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, kryetar i Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 649, datë 2.10.2019

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, "Për prefektin e qarkut", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Maksim Malaj emërohet prefekt i Qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 650, datë 2.10.2019

PËR SIGURIMIN E NDËRTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 42, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërtuesi/ zhvilluesi/ investitori i dorëzon blerësit, njëkohësisht me lidhjen e kontratës për kalimin e pronësisë së ndërtesës, një kontratë sigurimi me afat 10- (dhjetë-) vjeçar me përfitues blerësin/ blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve, në zbatim të pikës 9, të nenit 42, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar.

2. Kjo kontratë sigurimi mbulon dëmet e ndërtesës, që shfaqen pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin kur, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda.

3. Limiti i përgjegjësisë së kontratës së sigurimit nuk duhet të jetë më i ulët se vlera totale e çmimit të shitjes të përcaktuar në kontratën e kalimit të pronësisë së pasurisë paluajtshme.

4. Tarifa vjetore e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.1 (zero pikë një) për qind e shumës së sigurimit/limit të përgjegjësisë së përcaktuar në kontratën e sigurimit.

5. Noterët lidhin kontratën për kalimin e pronësisë së ndërtesës nga ndërtuesi/ zhvilluesi/ investitori tek blerësi, shoqëruar me kontratën e sigurimit 10- (dhjetë-) vjeçar në favor të blerësit/ blerësve të kryer nga shitësi, në përputhje me pikën 9, të nenit 42, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, si dhe me ligjin nr. 110/2018, "Për noterinë".

6. Kërkesa për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme të kontratave të kalimit të pronësisë së ndërtesës nga ndërtuesi/zhvilluesi/investitori te blerësi, shoqërohet edhe me kontratën e sigurimit 10- (dhjetë-) vjeçar në favor të blerësit/blerësve, të kryer nga ndërtuesi/ zhvilluesi/ investitori. Në rast mungese të kontratës së sigurimit, kërkesa për regjistrim të kontratës së kalimit të pronësisë nuk administrohet nga sporteli i shërbimeve kadastrale.

7. Elementet dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit miratohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe ministria përgjegjëse për financat.

8. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 651, datë 3.10.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 295, DATË 10.5.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 74, pika 1, e 76, pika 2, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 295, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 7/1 dhe 7/2, me këtë përmbajtje:

"7/1. Kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikat 2 e 5, të këtij vendimi.

7/2. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare, të parashikuar në pikat 2 e 5, të këtij vendimi.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 171, datë 27.9.2019

Në mbështetje të nenit 149, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 184, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neneve 32, 35, 36, 48 dhe 52, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrit dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

RREGULLORE
PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE PËR REKRUTIMIN, EMËRIMIN SI MAGJISTRAT DHE CAKTIMIN NË POZICION TË KANDIDATËVE PËR PROKURORË, SI DHE PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS SË PROKURORËVE

Në mbështetje të nenit 149, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 184, të ligjit nr. 115/ 2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", neneve 32, 35, 36, 48, dhe 52 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

I. QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kandidatëve për prokurorë, për emërimin magjistrat, caktimin në pozicionin e ngritjes në detyrë të kandidatëve prokurorë dhe për riemërimin e kandidatëve ish-prokurorë, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror, si dhe të proporcionalitetit.

2. Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme lidhur me procedurat që Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvillon për verifikimin e pasurisë, integritetit, të shkuarës profesionale dhe personale, si edhe të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për prokurorë, për emërimin magjistrat, caktimin në pozicion e ngritjen në detyrë të kandidatëve prokurorë dhe për riemërimin e kandidatëve ish-prokurorë.

II. SUBJEKTET QË I NËNSHTROHEN VERIFIKIMIT

Subjekte që i nënshtrohen verifikimit sipas kësaj rregulloreje janë:

a) Kandidatët për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës sipas nenit 32 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

b) Kandidatët për prokurorë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës sipas nenit 35 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

c) Ish-prokurorët që kandidojnë për t'u riemëruar magjistratë sipas nenit 36 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

ç) Prokurorët që kandidojnë për ngritje në detyrë sipas nenit 47, pika 1, shkronjat "a", "c" dhe "ç", si dhe nenit 55 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

III. KUADRI LIGJOR

Kjo rregullore zbatohet në përputhje me:

a) ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

b) ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (ligji për qeverisjen);

c) ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (ligji për statusin);

ç) ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

d) ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";

dh) ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";

e) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

ë) ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar;

f) ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;

g) ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

gj) ligjin nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

h) ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

i) ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësit civilë", i ndryshuar.

IV. PËRKUFIZIME

1. "Vendim verifikimi" është vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit, emërimit, riemërimit apo ngritjes në detyrë, si dhe të verifikimit të pasurisë dhe figurës, të subjekteve të përcaktuar në kreun II të kësaj rregulloreje.

2. "Procedurë verifikimi" është procesi administrativ i verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin, riemërimin, ngritjen në detyrë, si dhe i verifikimit të pasurisë

dhe figurës së subjekteve të përcaktuar në kreun II të kësaj rregulloreje.

3. "Këshilli" është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

4. "Komision" është Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i përbërë nga 3 anëtarë të përhershëm dhe/ose 2 anëtarë zëvendësues, i cili në bashkëpunim me relatorin, shqyrton aplikimet e subjekteve që i nënshtrohet procedurës së verifikimit.

5. "Relator" është anëtari i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, anëtari i përhershëm ose anëtari zëvendësues, i zgjedhur me short për të drejtuar dhe kryer në bashkëpunim me komisionin, procedurën e verifikimit, të subjekteve të përcaktuar në kreun II të kësaj rregulloreje.

6. "Kandidat" është personi që përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në kreun II të kësaj rregulloreje;

7. "Kandidatët ish-prokurorë", si rregull, janë personat që:

a) përmbushin kriteret e shkronjave "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të ligjit për statusin;

b) janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe kanë ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 5 vjet në 15 vitet e fundit;

c) nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 viteve të fundit përpara kërkesës për riemërim si magjistrat.

8. Përjashtimisht, për periudhën tranzitore, "Kandidatët ish-prokurorë", janë personat që:

a) janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe që kanë ushtruar funksionin si magjistrat të paktën për tre vjet ose;

b) personat që kanë ushtruar funksionin e magjistratit për 9 vjet, në 20 vitet e fundit, duke përfshirë gjyqtarët në një Gjykatë Ndërkombëtare, Gjykatë të Lartë, Gjykatë Kushtetuese;

c) nuk janë shkarkuar për shkelje disiplinore ose kryerjen e një vepre penale;

ç) nuk kanë mbajtur funksione politike në administratën publike ose funksione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara hyrjes në fuqi Ligjit për Statusin;

d) nuk kanë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar nga sigurimi i shtetit para vitit 1990;

dh) nuk kanë qenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të ndonjë shërbimi sekret.

8. ILDKPKI-ja është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

9. Komision i Pavarur i Kualifikimit është Komisioni i ngritur sipas ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

10. "Ekspert" është specialisti i një fushe të caktuar, që përzgjidhet nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara.

11. Formulari "Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë" është deklarata tip e miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

12. Formulari "Deklaratë e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit" është deklarata sipas nenit 6, pika 2, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

13. Formulari "Deklaratë e kontrollit të figurës" është deklarata sipas nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" dhe shtojcës A, të këtij ligji;

14. Formularët e "vetëdeklarimit" janë deklaratat sipas nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" dhe shtojcës B, të këtij ligji.

V. RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së verifikimit

1. Procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit:

a) jo më vonë se 7 ditë nga publikimi i listës përfundimtare të kandidatëve për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës;

b) jo më vonë se 7 ditë nga afati dy-javor i publikimit të listës së të diplomuarve për prokuror;

c) jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të prokurorëve për ngritjen në detyrë.

2. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin e relatorit për secilin kandidat. Shorti realizon shpërndarjen rastësore dhe të barabartë, në vijimësi, të ngarkesës së punës, midis anëtarëve të Komisionit. Këshilli, për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të Komisionit, mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti. Në çdo rast, procedura e shortit zhvillohet brenda afatit 7-ditor të përcaktuar në pikën 1 të kësaj rregulloreje.

3. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

4. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 171, 172, 173, dhe 174 të ligjit për qeverisjen, lidhur me verifikimin e një kandidati të caktuar, përpara fillimit të procedurës së shortit për atë kandidat apo në çdo kohë kur vjen në dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procesin e verifikimit, në mbledhjet e Komisionit ose në mbledhjen plenare të Këshillit për rastin e atij kandidati.

5. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.

6. Relatori i çështjes kujdeset për zhvillimin e procedimit individual të verifikimit dhe sidomos për sa më poshtë:

a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati;

b) përgatitjen e projekt-aktit administrativ;

c) koordinimin me kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

ç) koordinimin me kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

d) njoftimet për kandidatin.

7. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve realizohet në katër faza:

a) veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes;

b) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes;

c) shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Komisioni;

ç) shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Këshilli.

B. Të drejtat procedurale të kandidatit

1. Kandidati ka të drejtë të njoftohet për relatorin e çështjes menjëherë me fillimin e procedurës së verifikimit,

2. Kandidati ka të drejtë që, brenda 3 ditëve nga njoftimi për relatorin e çështjes, të kërkojë përjashtimin e tij, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara në nenin 174, të ligjit për qeverisjen, dhe relatori nuk heq dorë vetë nga shqyrtimi i çështjes. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

3. Vendimi për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit merret nga kryetari i Këshillit. Kur kërkohet përjashtimi i Kryetarit të Këshillit, vendimi merret nga zëvendëskryetari.

4. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë rregullore.

5. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

6. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së verifikimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e verifikimit të kandidatëve caktohen në ditë kalendarike.

2. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose

një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

3. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Ç. Njoftimet

1. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së verifikimit bëhen me:

a) shkresë, në adresën postare ose në adresën elektronike zyrtare për kandidatin prokuror apo;

b) në adresën postare ose elektronike të deklaruar për këtë qëllim, pranë Këshillit, nga kandidati jo prokuror.

2. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë Këshillit ose në adresën e tij elektronike, adresë e cila iu është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, me fillimin e procedurave të verifikimit të kandidaturave si dhe përmes publikimit të saj në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Kandidati ka detyrimin të njoftojë menjëherë me shkrim Këshillin për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës postare dhe elektronike të deklaruar.

VI. FAZAT E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE

A. Veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes dhe përjashtimi i tij

1. Pas caktimit me short, relatori i çështjes njofton kandidatin për fillimin e procedurës së verifikimit, duke i bërë të ditur të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtari të Këshillit.

2. Në rast se kandidati paraqet kërkesë për përjashtimin e relatorit të çështjes, Këshilli vendos jo më vonë se 3 ditë nga depozitimi i saj. Nëse relatori i çështjes përjashtohet, Këshilli zhvillon menjëherë procedurat e shortit për caktimin, ndërmjet 2 anëtarëve të tjerë dhe/ose atij zëvendësues të Komisionit, të një relatori të ri për çështjen e atij kandidati.

B. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes

1. Procedura e verifikimit të kandidatëve fillon dhe zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

2. Relatori i çështjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale dhe verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga kandidati.

3. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij, relatori i çështjes, ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisionit dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit të çështjes.

4. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njësisë Mbështetëse të Komisionit dhe personelin administrativ të Këshillit.

5. Kryetari i Këshillit është përgjegjës për marrjen e vendimeve për përjashtimin nga vendimmarrja ose konfirmimin e nëpunësve civilë në rast të shfaqjes së konfliktit të interesit.

6. Relatori i çështjes, në varësi të procesit konkret të kandidimit, realizon procedurat standarde si më poshtë:

a) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, sipas rastit:

i. formularin "Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë" ose;

ii. formularin "Deklaratë e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit" sipas kërkesave të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

iii. formularin "deklaratë e kontrollit të figurës" sipas kërkesave të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

iv. formularët e "vetëdeklarimit" sipas kërkesave të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

b) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularin e "vetëdeklarimit" sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

c) i dërgon, në rrugë elektronike, kandidatit të vitlindjes më të hershme se korrik 1977, formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29 të ligjit nr. 45/2015;

ç) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularin për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;

d) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularin autorizues për verifikimin, në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;

dh) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;

e) dërgon shkresat zyrtare për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

7. Relatori, përveç procedurave standarde, kryen veprime procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti.

8. Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme.

9. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori i çështjes konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës përkatëse të Këshillit. Kur i vlerëson të justifikuara motivet e paraqitura nga kandidati për mos përmbushjen e detyrimit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 5-ditor, relatori i çështjes i cakton një afat të ri të arsyeshëm.

10. Pas realizimit të procedurave të parashikuara në pikat 8 dhe 9 të këtij seksioni, relatori i çështjes procedon me dërgimin e shkresave zyrtare për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, nga institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

11. Në procedurën e verifikimit, relatori i çështjes shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, ku përfshihen:

a) formularët e deklarimeve të plotësuara;

b) aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatit;

c) si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Këshillit apo që relatori i çështjes vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore për kandidim.

12. Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit, pasi vë në dijeni Komisionin dhe me vendim të këtij të fundit, relatori i çështjes njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:

a) brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës përkatëse të Këshillit ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm;

b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjesë të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kritereve përkatëse ligjore, për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

13. Në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuara për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i çështjes i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

14. Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 8 deri 13 të këtij seksioni, kandidati:

a) nuk paraqitet;

b) nuk i përgjigjet njoftimeve të Këshillit;

c) nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar; ose

d) nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit; relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit.

15. Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, relatori i çështjes vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit. Komisioni, nëse verifikimet janë të plota, vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

16. Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit, pa qenë e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore. Komisioni vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

17. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projektaktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

C. Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Komisioni

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.

2. Në mbledhjen e Komisionit, Kryetari fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga kandidati i verifikuar.

3. Komisioni, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill nëse procedurat e verifikimit janë të plota, ose i kërkon relatorit të çështjes vijimin e procedurës së verifikimit, duke evidentuar dhe çështjet që kanë nevojë të verifikohen më tej.

4. Relatori i çështjes ka detyrimin të kryejë verifikimet e evidentuara nga Komisioni. Në përfundim të verifikimeve, relatori njofton kryetarin e Komisionit që çështja mund të rishqyrtohet nga Komisioni, duke vijuar procesin sipas pikave 1 deri 3, të këtij seksioni.

Ç. Shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit të verifikimit nga Këshilli

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga Kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, i njoftohet kandidatit të verifikuar. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Në mbledhjen e Këshillit, kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga kandidati i verifikuar.

4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të çështjes, nëse e vlerësojnë të nevojshme, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe t'i kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, Këshilli deklaron kalimin në fazën e diskutimeve, votimit dhe të dhënies së vendimit.

6. Në përfundim të diskutimeve, për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, me tej anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund kryetari i Këshillit. Kur votat

ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

7. Në rastin kur, pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e kandidatit të verifikuar, Këshilli vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, por në atë çështje nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 8 deri në 13 të seksionit B të këtij kreu, shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Kandidati ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetës, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e ardhjes në dijeni të materialit të dërguar nga Këshilli.

8. Pas diskutimeve dhe votimit të çështjes, Këshilli vendos:

a) lejimin e kandidatit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës ose ndalimin e kandidatit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës;

b) lejimin e kandidatit të diplomuar dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për emërimin e tij si prokuror ose ndalimin e kandidatit të diplomuar dhe refuzimin e emërimit të tij si prokuror;

c) lejimin e kandidatit ish-prokuror dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për riemërimin e tij si prokuror ose skualifikimin e kandidatit ish-prokuror dhe ndalimin e riemërimit të tij si prokuror;

ç) lejimin e kandidatit prokuror dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të ngritjes në detyrë ose ndalimin e kandidatit prokuror dhe përjashtimin e tij nga procedura e ngritjes në detyrë.

9. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë:

a) deklarimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë kandidati;

b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.

10. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit edhe në rastet kur, pas njoftimeve të Këshillit, gjatë procedurës së verifikimit, kandidati përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.

VII. VENDIMI I VERIFIKIMIT. E DREJTA E ANKIMIT

1. Vendimi i verifikimit të kandidatit arsyetohet dhe hartohet sipas kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

2. Përveç rastit kur ka mbetur në pakicë, arsyetimi i vendimit të Këshillit bëhet nga relatori i çështjes. Anëtari që ka mbetur në pakicë, arsyeton qëndrimin e tij, i cili i bashkohet vendimit.

3. Në çdo rast, vendimi i Këshillit arsyetohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e shpalljes.

4. Nëse për shkak të natyrës së çështjes, arsyetimi i vendimit kërkon kohë, Këshilli mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit të arsyetuar, jo më vonë se 3 ditë nga ajo e shpalljes.

5. Vendimi i verifikimit njoftohet sipas kërkesave të nenit 190 të ligjit për qeverisjen dhe bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

6. Ndaj vendimit të Këshillit për ndalimin e kandidimit, kandidati mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

VIII. PUBLIKIMI I AKTEVE TË PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT

1. Vendimet e Këshillit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare.

2. Në faqen zyrtare të Këshillit publikohen edhe:

a) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur ndalimi i kandidimit;

b) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur lejimi i kandidimit.

IX. PROCEDURA PËR VERIFIKIMIN E PASURISË, INTEGRITETIT DHE KOMPONENTËVE TË TJERË

Përveç kur parashikohet ndryshe në seksionet A, B, C dhe Ç të këtij kreu, për zhvillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të kushteve të tjera ligjore të kandidatit, zbatohen rregullat e përgjithshme të parashikuara në kreun V dhe kreun VI të kësaj rregulloreje.

A. Verifikimi i pasurisë së kandidatit

1. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidatit i dërgohen, në rrugë elektronike, formulari "Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë", si edhe informacioni mbi lidhjen elektronike zyrtare të ILDKPKI-së, në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë në rrugë elektronike këtë deklaratë, përfshirë udhëzimin përkatës për mënyrën e plotësimit të saj.

2. Njëkohësisht, kandidatit i dërgohen, në rrugë elektronike, edhe formularët e autorizimeve për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit të statusit, të kryejë verifikimin dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion, nga ILDKPKI-ja, si dhe nga organet e administratës tatimore dhe doganore, me të dhëna mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur. Autorizimet, të nënshkruara rregullisht nga kandidati dhe personat e lidhur, depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

3. Jo më vonë se 5 ditë nga ajo e nënshkrimit dhe dorëzimit nga kandidatët dhe personat e lidhur të autorizimeve sipas pikës 2 të këtij kreu:

a) Këshilli i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit të statusit;

b) relatori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkimit, nga organet e administratës tatimore dhe doganore, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur.

4. Jo më vonë se 15 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularit të deklarimit të pasurisë, kandidati e dorëzon atë të plotësuar pranë ILDKPKI-së. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të nenit 3/1, dhe nenit 4, pika 2 e vijues të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

5. ILDKPKI-ja njofton menjëherë Këshillin në rastin kur kandidati nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë.

6. ILDKPKI-ja kryen kontrollin e plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatit brenda 2 muajve nga paraqitja e saj.

7. Nëse gjatë 180 ditëve para asaj të paraqitjes së deklaratës, kandidati i është nënshtruar kontrollit të plotë nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, kur ILDKPKI-ja vlerëson se nuk është vendi për rikontroll të plotë sipas përcaktimit të pikës 4, të nenit 25/1, të ligjit nr. 9049/2003, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer.

8. ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit kopjen e deklarimit të bërë nga kandidati, si edhe gjetjet dhe përfundimet e këtij institucioni nga procedura e mëparshme e kontrollit të plotë të deklarimit. Në çdo rast, Këshilli kryen veprimet e parashikuara nga shkronja "b", e pikës 3, të këtij seksioni.

9. Pavarësisht parashikimit të pikës 9, të këtij seksioni, nëse pas fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatit, relatori vjen në dijeni, mbi informacionet dhe dokumentacionin e marrë nga institutcione të tjerë verifikues, për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në deklarimin e pasurisë së kandidatit, njofton menjëherë ILDKPKI-në për të ushtruar kompetencën e rikontrollit të plotë të deklarimit të kandidatit sipas parashikimeve neneve 3/1 dhe 25/1, pika 4, të ligjit nr. 9049/2003.

10. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur.

11. Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe të dhënat mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, të dërguara nga subjektet publike sipas kërkesës së Këshillit.

12. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë, relatori mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga ILDKPKI-ja, si dhe nga organet e administratës tatimore dhe doganore;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati dhe dokumente mbështetës, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet t'i paraqesë pranë zyrës së

protokollit të Këshillit. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

13. Në rastin kur në procedurën e verifikimin të pasurisë lind nevoja për njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e të dhënave që rezultojnë nga deklarimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga organet e administratës tatimore dhe doganore, relatori mund të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse.

14. Ekspertët përzgjidhen nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione të specializuara.

15. Ekspertët caktohen nga Komisioni, mbi propozimet e parashtruara nga relatori i çështjes. Shpenzimet e ekspertit përballohen nga buxheti i Këshillit.

16. Kandidati në verifikim, njoftohet menjëherë për ekspertin e caktuar nga Këshilli. Jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, kandidati njofton Këshillin, duke parashtruar me shkrim edhe motivet konkrete përkatëse, nëse pretendon gjendjen e papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit me ekspertin. Lidhur me pretendimet e kandidatit, Këshilli disponon sipas ligjit.

17. Përpara fillimit të detyrës, eksperti nënshkruan formulën e betimit. Pas veprimit të betimit, sipas udhëzimeve të relatorit, eksperti ka detyrimin të shqyrtojë aktet, të përgatisë, sipas rastit, raport financiar apo mendimin e tij me shkrim, si edhe të ruajë konfidencialitetin e të dhënave që siguron gjatë kryerjes së ekspertimit.

18. Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për lejimin apo ndalimin e kandidimit, trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti.

19. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat e dërguara nga organet e administratës tatimore dhe doganore, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë.

20. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, atyre të nxjerra nga të dhënat e dërguara nga organet e administratës tatimore dhe doganore, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e tij, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit. Komisioni vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

21. Ndalimi i kandidimit vendoset nga Këshilli, duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete të rastit dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, në rastet kur të dhënat e marra nga burime të ligjshme tregojnë se:

a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij;

b) kandidati nuk ka deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;

c) kandidati ka dhënë një deklarate të rreme ose jo të saktë të aseteve;

ç) kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

22. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe në rastet kur kandidati:

a) nuk ka plotësuar ose depozituar pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaratës së pasurisë;

b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

B. Verifikimi i figurës dhe integritetit të kandidatit

1. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidatit i dërgohet në rrugë elektronike:

a) formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike";

b) formulari i aplikimit sipas ligjit nr. 45/2015,"Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta";

c) informacion mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Këshillit, në të cilën kandidati mund të

marrë dhe plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, formularët sipas shkronjave "a" dhe "b" si më lart;

ç) formulari i autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për statusin, të kryejë verifikimin dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për verifikimin e figurës Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, Prokuroria, Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, me të dhëna mbi figurën dhe integritetin e tij.

2. Jo më vonë se 5 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularëve të parashikuar në pikën 1 të këtij seksioni, kandidati i dorëzon ato të plotësuara në zyrën e protokollit të Këshillit.

3. Kandidatët që kanë marrë certifikatën e pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse sipas:

a) ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, "Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare", si dhe;

b) ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik",

nuk mbartin detyrimin për plotësimin dhe dorëzimin e formularit të aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta" sipas ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", por duhet të dorëzojnë në zyrën e posaçme të Këshillit, certifikatën si më lart të pastërtisë së figurës nga institucionet përgjegjëse.

4. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

5. Relatori i çështjes dhe komisioni kryen verifikimet e rastit për të dhënat e deklaruara nga kandidati dhe, kur është rasti, kryetari i Këshillit përcjell formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme.

6. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit nr. 138/2015 dhe brenda 2 muajve nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni, i dërgon Këshillit raportin përkatës me përfundimet e procesit të verifikimit. Mosdërgimi në këtë afat i këtij raporti nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk përbën shkak pengues të procedurës së verifikimit të kushteve të emërimit/riemërimit/ngritjes në detyrë, si dhe të pasurisë dhe figurës së atij kandidati.

7. Relatori i çështjes, jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i vetëdeklarimit të kandidatit, të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015, në zyrën e protokollit të Këshillit, kryen edhe veprimet për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore sipas shkronjave "a" dhe "c" të pikës 12 të këtij seksioni, nga Byroja Kombëtare e Hetimit dhe shërbimet shtetërore informative.

8. Formulari i aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta" sipas nenit 29 të ligjit nr. 45/2015, i plotësuar vetëm nga kandidati i vitlindjes më të hershme se korrik 1977, i dërgohet menjëherë për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Mosdërgimi në kohë i informacionit nga ky Autoritet nuk përbën shkak pengues për vijimin verifikimit të kushteve të emërimit/riemërimit/ngritjes në detyrë, si dhe të pasurisë dhe figurës për atë kandidat.

9. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të figurës dhe integritetit të kandidatit, komisioni mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë seksion;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

10. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi

gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të figurës dhe integritetit të kandidatit.

11. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidatit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të integritetit dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

12. Ndalimi i kandidimit vendoset nga Këshilli në rastet kur nga raportet e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të institucioneve të tjera të përmendura në këtë seksion, konfirmohet se kandidati:

a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";

c) ka qenë ose është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

13. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur kandidati:

a) nuk ka plotësuar ose depozituar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015 dhe/ose formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/ zgjedhjes në poste të larta" sipas ligjit nr. 45/2015;

b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruar, autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit për statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij.

C. Verifikimi i kushteve të tjera ligjore të kandidimit

1. Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidatit i dërgohet, në rrugë elektronike, formulari i autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të ligjit të statusit, të kryejë verifikimin e të dhënave që lidhen me plotësimin e kriterit të zgjedhshmërisë sipas shkronjës "dh" të nenit 28 të ligjit për statusin, në çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit, si dhe të të dhënave që lidhen me plotësimin e kushteve të pajtueshmërisë sipas nenit 6 të ligjit për statusin, nga kryetari i prokurorisë përkatëse ku kandidati ka ushtruar funksionet. Autorizimi, i nënshkruar rregullisht nga kandidati, depozitohet pranë zyrës së protokollit të Këshillit, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

2. Relatori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati për të vlerësuar nëse, për efekt të verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit, të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë dhe nuk gjenden elementë që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij.

3. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerëson se të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, përmbajnë pasaktësi ose edhe elementë që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, relatori mund të kërkojë:

a) informacione nga çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit ose nga kryetari i prokurorisë përkatëse ku kandidati ka ushtruar funksionet;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga ardhja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës. Nëse për motive të justifikuara nuk mund të respektojë afatin 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Këshillin. Kur i vlerëson motivet si të justifikuara, relatori i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur shpjegimet lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit.

4. Nëse nga gjetjet e procesit të verifikimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

5. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga gjetjet e përfundimet e nxjerra nga shqyrtimi i shkresave të dërguara nga subjektet publike dhe private, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidatit, procedon

me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

6. Ndalimi i kandidimit vendoset nga Këshilli në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike apo private, rezulton se kandidati nuk plotëson ndonjërin prej kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të parashikuara, përkatësisht, nga nenet 6 dhe 28 të ligjit për statusin.

7. Ndalimi i kandidimit vendoset edhe kur kandidati ka refuzuar nënshkrimin e autorizimit për Këshillin që, në zbatim të pikës 2, të nenit 32, të ligjit për statusin, të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, sa i përket të dhënave që lidhen me plotësimin e kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit.

X. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

A. Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016

1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin.

2. Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin.

3. Vendimi i Këshillit për lejimin ose ndalimin për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë.

4. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit ose nuk përfundon procedurat e rivlerësimit për këta kandidatë brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, këta kandidatë i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin.

5. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, do t'i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas ligjit nr. 45/2015.

6. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve, për kandidatët që janë subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, shtrihet prej momentit kur vendimi i dhënë organet e rivlerësimit kalimtar merr formë të prerë.

7. Afati 180-ditor i përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me kryerjen e procedurës së verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë së kandidatëve që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, llogaritet nga dita e dorëzimit të plotësuar të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit pranë ILDKPKI-së.

8. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, fillojnë pas afatit 180-ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, shtrihet prej momentit kur vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë merr formë të prerë.

9. Kandidatët, subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe pasi është paraqitur ankim ndaj atij vendimi, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin.

C. Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve ish-prokurorë sipas nenit 166 të ligjit për statusin.

1. Gjatë periudhës së funksionimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kandidatët ish-prokurorë sipas nenit 166 të ligjit për statusin, i

nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016.

2. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë, sa i përket verifikimit të pasurisë dhe të figurës, do të mbështetet në vendimin e dhënë nga organet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

3. Vetëm kandidatët që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, me vendim përfundimtar, mund të kualifikohen nga Këshilli për t'u riemëruar.

4. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3 të këtij seksioni, kandidatët ish-prokurorë sipas nenit 166, të ligjit për statusin, do t'i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas ligjit nr. 45/2015.

5. Procedura e përcaktuar ne pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve ish-prokurorë sipas nenit 166 të këtij ligji, shtrihet për periudhën prej momentit kur vendimi i dhënë organet e rivlerësimit kalimtar për kualifikimin për emërim të tyre merr formë të prerë.

6. Afati 180-ditor i përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1, të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me kryerjen e procedurës së verifikimit dhe kontrollit të plotë të pasurisë së kandidatëve ish-prokurorë sipas nenit 166 të ligjit për statusin, llogaritet nga dita e dorëzimit të plotësuar të deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit pranë ILDKPKI-së.

7. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve ish-prokurorë sipas nenit 166 të ligjit për statusin, fillojnë pas afatit 180-ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, shtrihet prej momentit kur vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar për emërimin e tyre në detyrë merr formë të prerë.

8. Kandidatët ish-prokurorë sipas nenit 166 të ligjit për statusin, të cilët nuk janë kualifikuar për emërim me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe pasi është paraqitur ankim ndaj atij vendimi, nuk pranohen të kandidojnë për t'u riemëruar dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin.

9. Brenda dy viteve pas kalimit me sukses të procesit së rivlerësimit, kandidatët ish-prokurorë sipas nenit 166 të ligjit për statusin, mund të riemërohen si prokurorë nga Këshilli, duke pasur të drejtën për t'u caktuar në një pozicion për të cilin përmbushin kriteret, sipas nenit 47 të këtij ligji, si dhe të kandidojnë në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicione për magjistratë ose për pozicione të komanduara ose pozicione që mund të ushtrohen vetëm nga magjistratët.

Ç. Rregulla kalimtare për përmbylljen e procedurave të verifikimit

1. Për kandidatët që janë subjekt i procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, procedurat e verifikimit nuk mund të përfundojnë përpara periudhës 3-mujore nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, përveç rastit kur ky i fundit njofton Këshillin se nuk mund ta kryejë këtë procedurë brenda këtij afati.

2. Procedura e vlerësimit dhe pikëzimit për çdo kandidat të kualifikuar fillon menjëherë me përfundimin e procedurës së verifikimit, ndërsa renditja e kandidatëve që kandidojnë për të njëjtin pozicion të lirë, bëhet pasi të kenë përfunduar procedurat e verifikimit për të gjithë kandidatët për atë pozicion të lirë.

3. Procedura e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve rregullohet me akt të veçantë të Këshillit.

D. Dispozita të fundit

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë